





Funded by
the European Union



Regional Cooperation Council

Një udhëzues i shkurtër mbi analizën gjinore për Njësitë Qendrore për Armët e Zjarrit





Zyra Qendrore e Evropës Lindore dhe Juglindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (SEESAC) është iniciativë e përbashkët e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (KBR), e cila ka për qëllim forcimin e kapaciteteve kombëtare dhe rajonale për kontrollin dhe pakësimin e përhapjes dhe keqpërdorimit të armëve të vogla dhe të lehta, duke kontribuar kështu në rritjen e stabilitetit, të sigurisë dhe të zhvillimit në Evropën Juglindore dhe Lindore.

Ky botim është hartuar në kuadër të projektit rajonal *“Mbështetje për përmirësimin e luftës kundër zotërimit të jashtëligjshëm, keqpërdorimit dhe trafikimit të armëve të vogla dhe të lehta (AVL) në Ballkanin Perëndimor (IPA/2021/425–067)”*, të financuar nga Komisioni Evropian, Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit, përmes Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit.

Për më shumë informacion, kontaktoni:

Drejtuese e SEESAC
Bulevar Zorana Đinđića 64, 11000, Beograd, Serbi
Tel.: +381 11 415 5300
www.seesac.org

Deklaratë për mohimin e përgjegjësisë

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk pasqyrojnë në asnjë mënyrë pikëpamjet e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal apo të Bashkimit Evropian. Emërtimet e përdorura dhe prezantimi i materialeve në këtë botim nuk nënkuptojnë shprehjen e asnjë opinioni nga ana e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal apo të Bashkimit Evropian, për sa i përket: 1) statusit ligjor të një vendi, territori ose zone apo të autoriteteve apo grupeve të tij të armatosura; ose 2) përcaktimit të vijave kufitare ose kufijve të tij.

Redaktoi: Dragan Božanić

Dizajni dhe paraqitja grafike: KNAP

Përkthimi: Alba Global

Vendi dhe viti i botimit: Beograd 2025

Printimi: Bigraf Plus, Beograd

Qarkullimi: 15 copë

ISBN-978-86-7728-409-1

© SEESAC 2025 - Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Falënderime

Dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë për Ministritë e Brendshme dhe në veçanti, Njësitë Qendrore për Armët e Zjarrit (FFP-të) në Ballkanin Perëndimor për bashkëpunimin dhe kontributin e tyre për zhvillimin e këtij udhëzuesi. Udhëzuesi është hartuar si pjesë e asistencës gjithëpërfshirëse teknike të ofruar nga SEESAC për të përmirësuar kapacitetet analitike, operacionale dhe institucionale të FFP-ve në rajon.

Udhëzuesi është përgatitur nga Dragan Božanić, Specialist i projektit të SEESAC për hulumtimet dhe çështjet gjinore. Ai bazohet gjerësisht në *Trajnimin mbi aftësitë e të menduarit kritik dhe kapacitetet analitike dhe Trajnimin mbi analizën e inteligjencës për armët e zjarrit për FFP-të*, të realizuar përkatësisht nga Alain Lapon, Kryekëshilltar Teknik i SEESAC dhe Martin Van der Meji, Ekspert për Kontrollin e AVL-ve në SEESAC, të cilët kanë ofruar gjithashtu mbështetje të konsiderueshme gjatë zhvillimit të tij.

Udhëzuesi ka përfituar më tej nga kontributet dhe konstatimet e vlefshme të Jelena Bujaković, Specialiste e projektit për AVL-të dhe Juliana Buzi, Specialiste për Bashkëpunimin Rajonal.

Qëllimi dhe struktura e udhëzuesit

Udhëzuesi synon të mbështesë Njësitë Qendrore për Armët e Zjarrit (FFP-të) në integrimin e perspektivës gjinore në aktivitetet e tyre përmes mbledhjes së vazhdueshme të të dhënave me ndjeshmëri gjinore dhe zbatimit efektiv të analizës gjinore për të përmirësuar tablonë e inteligjencës. Duke u bazuar në procedurat ekzistuese standarde të veprimit, Udhëzuesi synon të lehtësojë integrimin e perspektivës gjinore në veprimtaritë e rregullta të FFP-ve dhe të shërbejë si një instrument praktik për trajtimin e aspekteve kyçe gjinore të krimeve me armë zjarri.

Udhëzuesi është i strukturuar në pesë kapituj.

Kapitulli i parë ofron një përmbledhje koncize të të dhënave kyçe që ilustrojnë dinamikat gjinore të kriminalitetit me armë zjarri dhe përvojat e ndryshme të grave dhe burrave në këtë kontekst. Gjithashtu, ai thekson aktivitetet kryesore të ndërmarra në Ballkanin Perëndimor për të integruar aspektin gjinor në kontrollin e AVL-ve, si edhe përpjekjet për të përmirësuar kapacitetet analitike, operacionale dhe institucionale të FFP-ve.

Kapitulli i dytë trajton rëndësinë strategjike të integrimit të perspektivës gjinore në veprimtaritë e Njësisë Qendrore për Armët e Zjarrit (FFP-të).

Kapitulli i tretë prezanton mbledhjen e të dhënave me ndjeshmëri gjinore dhe ofron një përmbledhje të detajuar të llojeve të ndryshme të statistikave gjinore përkatëse për punën e FFP-ve.


Kapitulli i katërt përqendrohet në analizën gjinore, ekzaminimin e marrëdhënies mes analizës gjinore dhe të kimit, dhe theksimin e rolit të analizës gjinore në krijimin një kuadri gjithëpërfshirës të inteligjencës. Për ta shtjelluar, ai prezanton një metodologji të personalizuar hap pas hapi për realizimin e analizës gjinore në kontekstin e veprimtarive të FFP-ve.

Dhe në fund, **kapitulli i pestë** nënvizon rëndësinë e integrimit të analizës gjinore në produktet analitike të FFP-ve.

Përfshihet gjithashtu një **fjalorth** që përkufizon konceptet kyçe të përdorura në udhëzues.

Tabela e përmbajtjes

Falënderime	5
Qëllimi dhe struktura e udhëzuesit	6
1. Hyrje	9
1.1 Pse është e rëndësishme perspektiva gjinore për të kuptuar dhe parandaluar krimet me armë zjarri?	10
1.2 Trajtimi i aspekteve gjinore të armëve të zjarrit në Ballkanin Perëndimor	11
2. Rëndësia strategjike e integritit të perspektivës gjinore në veprimtaritë e njësive qendrore për armët e zjarrit	15
3. Mbledhja e të dhënave me ndjeshmëri gjinore	19
3.1 Statistikat gjinore	20
4. Analiza gjinore	25
4.1 Analiza gjinore dhe analiza e krimit	27
4.2 Nga të dhënat në inteligjencë: roli i analizës gjinore	28
4.3 Udhëzimet hap pas hapi për integrimin e analizës gjinore në veprimtaritë e FFP-ve	29
Hapi 1: Mbledhja e të dhënave – marrja e informacionit për pozicionin e grave dhe burrave	31
Hapi 2: Inteligjenca me përgjegjshmëri gjinore – Identifikimi i modeleve gjinore	35
Rast studimor: Armët e zjarrit dhe dhuna në familje në Ballkanin Perëndimor	36
Hapi 3: Analizimi i shkaqeve kryesore – shqyrtimi i faktorëve pas modeleve të identifikuara	38
Rast studimor: Armët e zjarrit dhe dhuna në familje në Ballkanin Perëndimor	39
Hapi 4: Përgjigja ndaj modeleve gjinore të identifikuara	40
Hapi 5: Konsolidimi i një tabloje inteligjence me përgjegjshmëri gjinore	41
Hapi 6: Monitorimi i tendencave dhe vlerësimi i përgjigjes	45
5. Përdorimi i analizës gjinore në produktet analitike të njësive qendrore për armët e zjarrit	47
Rast studimor: Ekspozimi i meshkujve të rinj në moshë ndaj dhunës me armë zjarri – Përdorimi i analizës gjinore për profilizimin e problemit dhe të subjektit	49
FJALORTH	53
Burimet e Përzgjedhura të SEESAC për Gjininë dhe Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta	57



1. Hyrje

1.1 Pse është e rëndësishme perspektiva gjinore për të kuptuar dhe parandaluar krimet me armë zjarri?

Në Ballkanin Perëndimor, studimet e thelluara¹ kanë siguruar prova të konsiderueshme që dokumentojnë aspektet thellësisht gjinore të armëve të zjarrit dhe kriminalitetit të lidhur me armët e zjarrit, si edhe përvojat e ndryshme të grave dhe burrave në këtë kontekst. Studimet kanë treguar që aspektet gjinore të armëve të zjarrit vihen re në shpërndarjen e armëve të zjarrit (pronësia dhe kërkesa), në modelet dhe karakteristikat e krimit të lidhur me armët e zjarrit, në ndikimet e ndryshme të keqpërdorimit të armëve të zjarrit te gratë dhe burrat, ekspozimin e tyre ndaj dhunës me armë zjarri, rolin e armëve të zjarrit në dhunën me bazë gjinore dhe dhunës ndaj grave, si dhe në dallimet në përvojat dhe qëndrimet ndaj armëve të zjarrit.

Përmbledhja në vijim thekson të dhënat kyçe që ilustrjnë dinamikat gjinore të kriminalitetit me armë zjarri dhe përvojat e ndryshme të grave dhe burrave në këtë kontekst:

1. **Pronësia, kërkesa dhe aksesit ndaj armëve të zjarrit kanë natyrë thellësisht gjinore.** Në rajon, burrat zotërojnë 97,2% të të gjitha armëve të zjarrit në pronësi të ligjshme, ndërsa gratë zotërojnë vetëm 2,8%. Këto modele janë të qëndrueshme dhe mund të vërehen në tendencat vjetore të pandryshueshme të marrjes së lejeve të reja.

Të dhënat nga një anketim rajonal të kryer në vitin 2024 tregojnë që burrat kanë 3,5 herë më shumë gjasa se gratë për të raportuar se do të zotëronin një armë, 10,4% dhe 2,9% përkatësisht. Kjo është veçanërisht e dukshme mes burrave të grupmoshës 18–30 vjeç, të cilët janë më të prirur të kenë qëndrim pozitiv ndaj zotërimit të armëve të zjarrit se sa burrat e çdo grupmoshe tjetër.

Përveç zotërimit të armëve të zjarrit nga civilët, burrat dominojnë ndjeshëm në profesionet e sektorit të sigurisë dhe aktivitetet që përfshijnë armët e zjarrit. Studimet e mëparshme të SEESAC zbuluan se 91,2% e personelit të sektorit të sigurisë të autorizuar për të mbajtur armë zjarri në rajon ishin burra, krahasuar me 8,8% gra. Për më tepër, burrat mbizotërojnë gjithashtu në aktivitetet si gjuetia dhe sporti i qitjes, të cilat japin akses të rregullt në armët e zjarrit.

2. **Modelet e veprave penale kanë natyrë thellësisht gjinore, ku incidentet që përfshijnë armët e zjarrit kryhen kryesisht nga burrat.** Në vitin 2024, burrat përbënin 98% të autorëve të incidenteve me armë zjarri, çka konfirmon modelet e dokumentuara më parë. Dhuna me armë nga burrat lidhet gjithashtu me moshën, ku meshkujt e rinj në moshë kanë më tepër gjasa që të keqpërdorin armët e zjarrit se sa burrat e grupmoshave të tjera. Vetëm në vitin 2024, burrat e grupmoshës 19 deri në 35 vjeç përbënin thujse gjysmën (45%) e të gjithë autorëve të incidenteve me armë zjarri.
3. **Rreziqet e lidhura me armët e zjarrit ndryshojnë ndjeshëm te gratë dhe burrat.** Dhuna me armë kundër burrave ndodh kryesisht në kontekste kriminale, nga

¹ Për më shumë detaje, shihni faqen e internetit të SEESAC, Baza e Njohurive rreth AVL-ve, seksioni [Gjinia dhe AVL-të](#)

mosmarrëveshjet në publik dhe nga të shtënat për shkaqe të papërcaktuara. Analiza e SEESAC ka dokumentuar që, nga të gjithë burrat e vrarë me armë zjarri në rajon, 24,9% janë vrarë në mosmarrëveshjet në publik, 24,4% në kontekstet kriminale, 23,4% nga të shtënat për shkaqe të papërcaktuara, dhe 11% nga dhuna në familje, vrasje të kryera pothuajse vetëm nga anëtarë të tjerë burra të familjes.

4. **Gratë përbëjnë shumicën e viktimave të dhunës me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje.** Burrat kanë më shumë gjasa që t'i keqpërdorin armët e zjarrit se sa të bien viktima të tyre, ndërsa gratë kanë dhjetë herë më shumë gjasa të jenë viktima sesa autore të incidenteve me armë zjarri. Ky përfaqësim joproporcional i grave mes viktimave të dhunës me armë zjarri lidhet kryesisht me përdorimin e armëve të zjarrit në kontekstet e dhunës në familje dhe dhunës nga partneri intim. Mes vitit 2019 dhe 2023, 68,4% e të gjitha grave të vrara me armë zjarri në rajon u vranë nga anëtarët e familjes, krahasuar me 10,9% të burrave. Gratë janë veçanërisht në rrezik të vriten me armë zjarri nga partnerët e tyre intimë. Kjo përbën 50,7% të të gjitha vrasjeve të grave (femicidet) me armë zjarri në rajon.
5. **Këto tendenca me natyrë gjinore të veprave penale, viktimizimit, dhunës me bazë gjinore, pronësisë dhe kërkesës janë tejet të qëndrueshme, ku janë regjistruar vetëm luhatje të vogla.** Siç është diskutuar më poshtë në këtë udhëzues, normat, rolet dhe pabarazitë mbizotëruese me natyrë gjinore, duke u ndërtuar në mënyrë komplekse me faktorë të tjerë, formësojnë dhe kontribuojnë në përvojat specifike dhe rreziqet me të cilat gratë dhe burrat përballen për sa i përket armëve të zjarrit dhe kriminalitetit të lidhur me armët e zjarrit.

1.2 Trajtimi i aspekteve gjinore të armëve të zjarrit në Ballkanin Perëndimor

Përgjegjshmëria gjinore në kontrollin e armëve të zjarrit/armëve të vogla² i referohet legjislacionit, politikave, programeve dhe veprimtarive për kontrollin e armëve, të cilat marrin në konsideratë dhe trajtojnë në mënyrë aktive përvojat dhe rolet e ndryshme të grave, burrave, vajzave dhe djemve në lidhje me armët e vogla (kontrollin) si edhe rreziqet specifike gjinore me të cilat ata përballen në lidhje me përhapjen dhe keqpërdorimin e armëve të vogla.

Nga ana tjetër, neglizhimi i dimensioneve gjinore të përdorimit, keqpërdorimit dhe zotërimit të armëve të zjarrit, siç është dokumentuar në studimet e mëparshme të SEESAC, pengon ndjeshëm efektivitetin e masave që synojnë parandalimin e kriminalitetit me armë zjarri dhe të dhunës me armë. Pasojat e kësaj qasjeje të ashtuquajtur **qasje e verbër nga ana gjinore** janë të dukshme në tendencat e vazhdueshme, duke përfshirë mbizotërimin e vrasjeve të grave të kryera me armë zjarri dhe rritjen e cenueshmërisë së meshkujve të rinj në moshë ndaj dhunës me armë, qoftë si autorë por edhe si viktima.

2 Në kontekstin e këtij udhëzuesi, termat "armë zjarri", "armë të vogla", dhe "armë" përdoren në vend të njëra tjetrës.

Kutia 1: Çfarë është integrimi i perspektivës gjinore?³

Integrimi i perspektivës gjinore është miratuar ndërkombëtarisht si një strategji kyçe për ta bërë barazinë gjinore realitet.

Përkufizimi i OKB-së për integrimin e perspektivës gjinore [ECOSOC (1997/2)] është: "Procesi i vlerësimit të pasojave të çdo veprimi të planifikuar të gratë dhe burrat, përfshirë legjislativonin, politikën ose programet në të gjitha fushat dhe nivelet. Është një strategji për t'i kthyer shqetësimet dhe përvojat e grave dhe të burrave në një pjesë integrale të

përgatitjes, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të politikave dhe programeve në sferat politike, ekonomike dhe shoqërore, në mënyrë që gratë dhe burrat të përfitojnë në mënyrë të barabartë dhe të mos ketë pabarazi. Synimi përfundimtar është arritja e barazisë gjinore."

Në këtë udhëzues, termat "integrimi gjinor" dhe "integrimi i perspektivës gjinore" përdoren në vend të njëra tjetrës.

Në bashkëpunim me institucionet në rajon, SEESAC ka ndërmarrë një grup aktivitete gjithëpërfshirëse për të mbështetur integrimin gjinor në kontrollin e AVL-ve, duke përfshirë:

- përforcimin e kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse për kontrollin e armëve në kuadër të integritimit gjinor në punën e tyre (përmes trajnimeve, mentorimeve, mbështetjes këshillimore, dhe zhvillimit të mjeteve praktike),
- hulumtimet dhe mbledhjen e vazhdueshme të të dhënave, dhe mbështetjen për zhvillimin e politikave dhe veprimtarive të mbështetura në prova dhe me përgjegjshmëri gjinore për kontrollin e armëve në rajon,
- rritjen e ndërgjegjësimit rreth lidhjeve mes aspekteve gjinore dhe armëve të vogla,
- rritjen e pjesëmarrjes së grave në procesin e hartimit të politikave për kontrollin e armëve.

Analiza gjinore në shkallë të gjerë për legjislativonin dhe politikën e kontrollit të armëve të vogla që u realizua në vitin 2021 doli në përfundimin se institucionet e Ballkanit Perëndimor kanë pasur një progres të konsiderueshëm për integrimin e perspektivës gjinore në politikën e kontrollit të armëve të vogla dhe rritjen e përgjegjshmërisë së tyre gjinore. [Strategjitë dhe planet e veprimit për kontrollin e AVL-ve](#) të miratuara në rajon **përfshijnë objektiva specifike për të integruar plotësisht perspektivën gjinore dhe të moshës në kontrollin e AVL-ve**. Për këtë qëllim, janë parashikuar shumë masa, duke përfshirë:

- zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve institucionale për integrimin gjinor,
- përmirësimin e praktikave të regjistrimit të të dhënave dhe mbledhjes së të dhënave me ndjeshmëri gjinore,
- trajtimin e lidhjeve midis armëve të zjarrit dhe dhunës në familje,

- përgjigjen ndaj aspekteve gjinore të kërkesës, përdorimit dhe keqpërdorimit të armëve të zjarrit, duke përfshirë lidhjet midis normave sociale mbizotëruese të burrërisë dhe armëve të zjarrit,
- ritjen e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave në kontrollin e armëve.

Analiza tregoi që përpjekjet e ardhshme duhet të mbështesin specifkisht institucionet për integrimin e aspekteve gjinore në nivel operacional dhe, kështu, të tregojnë me qartësi vlerën praktike që i sjell përpjekjeve për kontrollin e armëve.

Këto masa janë zbatuar në kuadër të projektit rajonal “Mbështetje për përmirësimin e luftës kundër zotërimit të jashtëligjshëm, keqpërdorimit dhe trafikimit të armëve të vogla dhe të lehta (AVL) në Ballkanin Perëndimor”, të financuar nga Komisioni Evropian, Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit, përmes Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA II). Përmes këtij projekti, SEESAC i ofron mbështetje autoriteteve të Ballkanit Perëndimor për të integruar perspektivën gjinore në masat e kontrollit të AVL-ve. Kjo përfshin, për shembull, zhvillimin e udhëzimeve praktike me përgjegjshmëri gjinore për miratimin e lejeve për armë zjarri⁴ dhe të udhëzimeve për vlerësimin e duhur të rreziqeve dhe parandalimin e përdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje.⁵

Për sa i përket FFP-ve, SEESAC ka ofruar asistencë teknike, trajnime dhe nisma gjithëpërfshirëse për bashkëpunimin rajonal për të përmirësuar kapacitetet e tyre analitike, operacionale dhe institucionale. Këtu përfshihen zhvillimi i procedurave standarde të veprimit, trajnime të specializuara në çështje si aftësitë analitike, hetimet online, inteligjenca nga burime të hapura, dhe të menduarit kritik, si edhe mbështetja teknike e synuar. SEESAC mbështeti gjithashtu përforsimin e bashkëpunimit mes FFP-ve, prokurorëve, ekspertëve të balistikës dhe njësisë të tjera ligjzbatuese, duke përmirësuar zinxhirin nga inteligjenca te provat dhe duke rritur përdorimin e produkteve analitike në hetime dhe procedime penale. Për më tepër, duke mbështetur pjesëmarrjen e tyre në ditët e përbashkëta të veprimit, vizitat studimore dhe shkëmbimet me palët homologe të BE-së, SEESAC ka ndihmuar në harmonizimin e metodologjive rajonale me standardet e BE-së dhe të Ekspertëve Evropianë për Armët e Zjarrit (EFE).

Përmes organizimit të Takimeve Vjetore të FFP-ve që prej vitit 2018, SEESAC ka mbështetur themelimin e një platforme kyçe rajonale të koordinimit për inteligjencën e armëve të zjarrit, duke mundësuar shkëmbimin sistematik të njohurive, harmonizimin e qasjeve analitike, dhe koherencë në mbarë rajonin për trajtimin e kërcënimeve të reja. Këto përpjekje kanë rezultuar në përmirësime të matshme për sa i përket cilësisë, konsistencës dhe shpeshësisë së rezultateve analitike, në ndarjen e zgjeruar të informacionit në rajon dhe në përforsimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, duke përfshirë gjurmimin dhe angazhimin me mekanizmat e BE-së.

Në këtë kontekst, FFP-të kanë marrë gjithashtu mbështetje për të integruar perspektivën gjinore në veprimtaritë e tyre. Për këtë qëllim, në vitin 2022 është mbajtur një seminar rajonal për aspektet gjinore të krimeve me armë zjarri, dhe në vitin 2024 është mbajtur një seminar këshillimor për zhvillimin e këtij udhëzuesi, i cili kombinon këtë proces dhe nevojat e prioritetet e shprehura të FFP-ve të identifikuara përmes konsultimeve.


4 SEESAC, 2024, Udhëzimet për miratimin me ndjeshmëri gjinore të lejeve për armë zjarri.

5 SEESAC, 2024, Udhëzimet për vlerësimin dhe adresimin e rreziqeve që lidhen me keqpërdorimin e armëve të zjarrit në dhunën në familje

Udhëzuesi gjithashtu bazohet gjerësisht në *Trajnimin mbi aftësitë e të menduarit kritik dhe kapacitetet analitike dhe Trajnimin mbi analizën e inteligjencës për armët e zjarrit për FFP-të të ofruar nga SEESAC përkatësisht në vitin 2022 dhe 2024.*

Mësimet kryesore

- Armët e zjarrit dhe kriminaliteti i lidhur me armët e zjarrit kanë natyrë thellësisht gjinore. Gratë dhe burrat kanë përvoja të ndryshme me armët e zjarrit dhe përballen me rreziqe specifike gjinore.
- Normat dhe rolet mbizotëruese gjinore, si edhe konceptet dominante mbi burrërinë dhe feminilitetin, formësojnë këto përvoja, në ndërthurje me faktorë të tjerë.
- Kontrolli i armëve të vogla me përgjegjshmëri gjinore trajton dhe u përgjigjet përvojave dhe rreziqeve të ndryshme specifike gjinore të grave, burrave, vajzave dhe djemve në lidhje me armët e zjarrit.
- Nga ana tjetër, neglizhimi i dimensionit gjinor në kontrollin e armëve pengon efektivitetin e përpjekjeve për të parandaluar dhunën me armë zjarri, ku pasojat e kësaj qasjeje të verbër nga ana gjinore janë të dukshme në tendencat e vazhdueshme.



2. Rëndësia strategjike e integritit të perspektivës gjinore në veprimtaritë e njësisive qendrore për armët e zjarrit

Njësia Qendrore për Armët e Zjarrit (FFP) ofron shërbime të integruara të inteligjencës taktike dhe strategjike për të informuar dhe mbështetur agjencitë ligjzbatuese për të kuptuar më mirë dhe trajtuar në mënyrë efektive krimin e lidhur me armët e zjarrit.⁶

Për ta arritur këtë, FFP-ja mbledh informacion, zhvillon inteligjencë përmes analizimit, dhe përmirëson qarkullimin e informacionit në lidhje me zotërimin e jashtëligjshëm, përdorimin për qëllime kriminale dhe trafikimin e armëve të zjarrit, komponentëve kryesore dhe municioneve të tyre në drejtim të juridiksioneve dhe brenda tyre, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe në nivelet strategjike dhe operacionale.

Duke pasur parasysh aspektet thellësisht gjinore të armëve të zjarrit dhe kriminalitetit të lidhur me armët e zjarrit, tabloja e inteligjencës duhet të pasqyrojë edhe këto dinamika. Për këtë arsye, njohja e qartë e modeleve gjinore të veprave penale, viktimizimit dhe ndikimit të keqpërdorimit të armëve të zjarrit, si edhe të shpërndarjes së armëve të zjarrit është integrale për zhvillimin e një tabloje gjithëpërfshirëse të inteligjencës. Integrimi i vazhdueshëm i një perspektive gjinore në veprimtaritë e FFP-së është një parakusht jetik për krijimin e inteligjencës me përgjegjshmëri gjinore, e cila pasuron me informacione përgjigjet efektive me politika dhe operacionale.

Nga ana operacionale, një kuptim i tillë i modeleve gjinore në kriminalitetin me armë zjarri informon të gjithë procesin e mbledhjes së të dhënave, analizimit dhe prodhimit të inteligjencës, duke siguruar që karakteristikat dhe dinamikat e tendencave dhe problematikave të lidhura me armët e zjarrit të identifikohen me saktësi dhe të trajtohen në mënyrë efektive.

Në Ballkanin Perëndimor, janë miratuar **procedurat standarde të veprimit (PSV-të) për FFP-të**, ku janë përcaktuar koncepti, qëllimi, vizioni dhe funksionet kryesore të FFP-së.

PSV-të theksojnë rëndësinë e aspekteve gjinore, veçanërisht në krijimin e një baze njohurish dhe të kuptuari të krimeve me armë zjarri, si dhe në zhvillimin e një kuadri më të gjerë të inteligjencës, duke përfshirë aspektet gjinore të krimeve me armë zjarri. FFP-ja është përgjegjëse për të siguruar që **analiza gjinore të integrohet në të gjitha fazat, duke përfshirë në mbledhjen dhe integrimin e inteligjencës**, vlerësimet e inteligjencës strategjike, të tilla si vlerësimet e kërcënimit, paketat e inteligjencës për operacionet taktike, raportet e posaçme të inteligjencës, parashikimin e masave dhe shqyrtimin horizontal, si dhe hartimin e rekomandimeve.

Për këtë qëllim, PSV-të parashikojnë specifikisht që FFP-ja duhet:

- të grumbullojë dhe integrojë një grup të të dhënave të inteligjencës, me ndjeshmëri gjinore, gjithëpërfshirëse dhe të përditësuara, për armët e zjarrit dhe inteligjencën balistike.
- të hartojë rekomandime për shmangien dhe parandalimin e krimeve me armë zjarri, duke përfshirë për aspektet gjinore të krimeve me armë zjarri.
- të hartojë dhe shpërndajë raporte statistikore të nevojshme për monitorimin e aspekteve gjinore të krimeve me armë zjarri, duke përfshirë të lidhjeve me dhunën me bazë gjinore, për të lehtësuar rritjen e përgjegjshmërisë gjinore në legjisllacionin, politikat dhe përgjigjet operacionale përkatëse përmes përdorimit të analizës gjinore në mënyrë më gjithëpërfshirëse dhe sistematike.

- t'u japë statistika, informacione, vlerësime dhe raporte, duke përfshirë statistikat e lidhura me gjininë, pikave përkatëse të kontaktit për përdorim në nivel ndërkombëtar.
- të japë detaje shitesë rreth armës së përdorur në krim përtej identifikimit të balistikës, duke përfshirë çdo metodë konvertimi të zbatuar ose karakteristika të tjera të rëndësishme që mund të ndihmojnë hetimin, si edhe rreth aspekteve të krimit që lidhen me gjininë.

PSV-të përcaktojnë më tej që produktet e inteligjencës të prodhuara nga FFP-ja, si raportet e posaçme të inteligjencës, vlerësimet taktike dhe strategjike, profilet e problemit dhe profilet e subjektit, duhet të bazohen në analizat e shëndosha gjinore.






Ky udhëzues synon t'i mbështesë FFP-të në këto përpjekje dhe të përmirësojë efektivitetin e tyre operacional duke integruar një perspektivë gjinore në aktivitetet e tyre. Kjo do të arrihet përmes:

- Sigurimit të mbledhjes së qëndrueshme të të dhënave me ndjeshmëri gjinore për të përmirësuar disponueshmërinë e statistikave gjinore; dhe
- Përdorimit të vazhdueshëm të analizës gjinore për të përmirësuar tablonë e inteligjencës.

Përmes kësaj, udhëzuesi synon kryesisht të mbështesë integrimin e një perspektive gjinore në veprimtaritë e rregullta që kryhen tashmë nga specialistët e FFP-së, dhe shërben si një mjet ndihmës që profesionistët të trajtojnë më mirë shqetësimet gjinore në punën e tyre të përditshme, duke u bazuar në procedurat dhe proceset ekzistuese të punës.

Mësimet kryesore

- Në Ballkanin Perëndimor, u miratuan PSV-të gjithëpërfshirëse për FFP-në, të cila vinin në pah integrimin e analizës gjinore në të gjitha fazat e inteligjencës kriminalistike të lidhur me armët e zjarrit.
- Aspektet gjinore janë thelbësore për të gjitha funksionet kyçe të FFP-ve, duke përfshirë:
 - mbledhjen dhe integrimin e një grupi gjithëpërfshirës dhe të përditësuar të dhënash mbi armët e zjarrit,
 - vlerësimin strategjik të inteligjencës që përshkruan shkallën dhe natyrën e kriminalitetit me armë zjarri,
- paketat e inteligjencës për operacionet taktike që synojnë aspektet kyçe të kriminalitetit me armë zjarri, si profilizimi i problemit, profilizimi i subjektit dhe vlerësimet taktike.



3. Mbledhja e të dhënave me ndjeshmëri gjinore

Në kontekstin e këtij udhëzuesi dhe të Procedurave Standarde të Veprimit për FFP-të, mbledhja e të dhënave me ndjeshmëri gjinore i referohet procesit sistematik të mbledhjes dhe kategorizimit të të dhënave në një mënyrë të atillë që njeh dhe pasqyron aspektet gjinore të kriminalitetit me armë zjarri, si dhe përvojat dhe rreziqet e ndryshme me të cilat përballen gratë dhe burrat në këtë aspekt. Ajo kontribuon në krijimin e një grupi të dhënash inteligjence me ndjeshmëri gjinore mbi armët e zjarrit dhe balistikën, të cilat FFP-të e përdorin për ushtrimin e funksioneve të tyre.

Mbledhja e të dhënave me ndjeshmëri gjinore mbështetet në konceptet dhe metodat me ndjeshmëri gjinore për të siguruar që të dhënat e mbledhura të jenë domethënëse për përparimin e analizës gjinore, të hulumtimit, politikëbërjes dhe veprimtarive. Ajo synon të shmangë paragjykimet gjinore në metodologjitë, mjetet ose matjet, dhe t'i japë përparësi përfshirjes së çështjeve që janë kritike për të kuptuar barazinë gjinore në kontekstin e kontrollit të AVL-ve.

3.1 Statistikat gjinore⁷

Mbledhja e të dhënave me ndjeshmëri gjinore prodhon **statistikat gjinore** që synojnë të kuptojnë pozicionin e vërtet të grave dhe burrave në shoqëri, si dhe realitetet specifike të jetëve të tyre. Për këtë arsye ato duhet të pasqyrojnë në mënyrë të përshtatshme dallimet dhe pabarazitë në pozicionin e grave dhe burrave në të gjitha fushat e jetës.

Statistikat gjinore kërkojnë gjithashtu një përpjekje aktive për të siguruar **që statistikat e lidhura me individët të mblidhen, përpilohen, analizohen dhe prezantohen sipas seksit dhe moshës, të pasqyrojnë problematikat dhe pikëpyetjet përkatëse për gratë dhe burrat në shoqëri**, dhe të jenë të harmonizuara me angazhimet ndërkombëtare.

Statistikat gjinore janë thelbësore për përparimin e analizës gjinore, hulumtimit dhe politikave e veprimtarive të bazuara në fakte. Institucionet i mbledhin, analizojnë dhe përdorin këto statistika për të identifikuar mangësitë, informuar politikën dhe veprimtaritë, dhe për të monitoruar progresin me kalimin e kohës.

Në kontekstin e kontrollit të AVL-ve, statistikat gjinore duhet të pasqyrojnë në mënyrë të përshtatshme mënyrën se si burrat dhe gratë i përjetojnë modelet e veprave penale dhe viktimizimit, rreziqet specifike me të cilat përballen për sa i përket armëve të zjarrit, veçanërisht në lidhje me dhunën me bazë gjinore, si edhe modelet e shpërndarjes së armëve të zjarrit.

Statistikat gjinore përfshijnë disa lloje të dhënash:

a) Të dhënat e ndara sipas seksit.

Këto janë të dhënat e mbledhura dhe kategorizuara sipas seksit, një karakteristikë

⁷ Ky seksion bazohet në Integrimin e perspektivës gjinore në statistika të vitit 2016, të Departamentit të Çështjeve Ekonomike dhe Sociale të Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara dhe në Kurrikulën e trajnimit për statistikën gjinore të vitit 2024, të UN Women.


individuale përgjithësisht e regjistruar në censuse, anketa dhe të dhëna administrative si një klasifikim primar dhe i përgjithshëm. Statistikat e ndara sipas seksit janë të dhënat që mbledhen, analizohen dhe prezantohen ose tabulohen veçmas si për gratë dhe për burrat.

Shembull: numri i zotëruesve të armëve të zjarrit ose numri i viktimave të vrasjeve me armë zjarri të ndara sipas seksit (gra/burra).


Të dhënat e ndara sipas seksit janë një pikënisje — kur analizohen, ato mund të zbulojnë dallimet në jetët e grave dhe të burrave që vijnë si rezultat i roleve dhe pritshmërive gjinore. Duke i ndarë të dhënat ose duke i mbledhur ato të ndara, FFP-të mund të zbulojnë tendenca ose lidhje, të cilat në të kundërt, mund të mbeten të fshehura në të dhënat e agreguara, duke i lejuar që të identifikojnë dhe përcaktojnë me më shumë efektivitet problemet specifike.

Për shembull, të dhënat e agreguara mbi marrëdhënien mes viktimave dhe autorëve tregojnë që incidentet me armët e zjarrit zakonisht ndodhin mes miqsh, të njohurish, ose fqinjëve, më pas vijnë të panjohurit, më pas anëtarët e familjes, dhe në fund, partnerët intimë (figura 1).

Figura 1: **Marrëdhënia mes viktimave dhe autorëve të incidenteve me armë zjarri**



Megjithatë, kur këto të dhëna ndahen sipas seksit, dalin në pah modele të ndryshme përvojash dhe rreziqesh. Ato tregojnë që gratë janë shumë herë më të cenueshme ndaj keqpërdorimit të armëve të zjarrit në situatat që përfshijnë dhunën në familje, ndërsa burrat përballen me rreziqe më të mëdha nga dhuna në kontekste të tjera. Në veçanti, të dhënat e ndara tregojnë që gratë kanë 40 herë më shumë gjasa se burrat që të përjetojnë keqpërdorimin e armëve të zjarrit nga partnerët e tyre intimë, duke theksuar kështu rëndësinë e zhvillimit të përgjigjeve të personalizuara dhe informuara për t'i trajtuar këto rreziqe specifike gjinore.

Figura 2: **Marrëdhënia mes viktimave dhe autorëve, sipas seksit të viktimës**

Përveç ndarjes sipas seksit, të dhënat duhet të **ndahen gjithashtu sipas moshës**, duke qenë se shumë modele, sjellje dhe ndikime ndryshojnë ndjeshëm me moshën. Për shembull, në kontekstin e kriminalitetit me armë zjarri, meshkujt e rinj të grupmoshës 18–30 janë më të ekspozuar në mënyrë joproporcionale ndaj dhunës me armë, si autorë por edhe si viktimë. Pa të dhëna të qëndrueshme me ndarje sipas seksit dhe moshës, këto shqetësime kritike mbeten të padukshme, duke penguar zhvillimin dhe zbatimin e masave parandaluese efektive.

Ndarja e mëtejshme e të dhënave mundëson informacione të detajuara dhe zhvillimin e një tabloje më gjithëpërfshirëse të inteligjencës. Sipas rastit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për privatësinë e të dhënave, mund të regjistrohen edhe variabla të tjera, si për shembull aftësia e kufizuar, etnia, gjendja civile, orientimi seksual, identiteti gjinor, vendi i rezidencës, gjendja sociale dhe ekonomike, dhe të tjera.

Të dhënat e ndara të paktën sipas seksit dhe moshës janë një parakusht për të kuptuar ndikimet specifike gjinore të keqpërdorimit të armëve të vogla, dhe për projektimin e nismave të bazuara në fakte dhe me përgjegjshmëri gjinore për t'i trajtuar ato. Pa informacion të saktë mbi rreziqet e ndryshme që armët e vogla paraqesin për gratë dhe burrat dhe nevojat e tyre specifike të sigurisë, ndërhyrjet për kontrollin e armëve të vogla rrezikojnë të jenë të “verbra nga ana gjinore”, çka mund të pengojë aftësinë e tyre për të arritur rezultate të dobishme për gratë dhe vajzat.⁸

b) Të dhënat që lidhen specifikisht me gratë ose burrat

Kjo i referohet informacionit të mbledhur mbi karakteristikat, përvojat, sjelljet ose kushtet specifike që janë unike për, ose prekin kryesisht, gratë ose burrat. Këto lloje të dhënash shkojnë përtej statistikave të përgjithshme të popullsisë për t'u fokusuar specifikisht në realitetet e ndryshme të secilit seks, që mund të formohen nga faktorët biologjikë, socialë, kulturorë ose ekonomikë.

Në kontekstin e këtij udhëzuesi, vrasjet e grave (femicidet) të kryera me armë zjarri — të përkufizuara si vrasja e një gruaje nga një burrë e motivuar nga urrejtja për femrat, mospërfillja, kënaqësia, një ndjenjë zotërimi, ose pushteti ndaj grave — janë një shembull i këtyre të dhënave.





c) Të dhënat që pasqyrojnë problematikat gjinore

Për sa i përket këtij lloji të dhënash, është e rëndësishme të theksohet që disa prej statistikave që ofrojnë një perspektivë gjinore nuk janë domosdoshmërisht të ndara sipas seksit, por sidoqoftë pasqyrojnë problematikat gjinore. Për shembull, ndikimi në mënyrë joproporcionale i keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje ndaj grave është një problematikë gjinore. Si rrjedhojë, *të dhënat mbi numrin e incidenteve me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje, ose për numrin e lejeve të armëve të zjarrit që janë revokuar për shkak të dhunës nga partnerët intimë ose në familje pasqyrojnë problematikat gjinore*, edhe nëse të dhënat në vetvete nuk janë të ndara sipas seksit. Shembuj të tjerë për këto të dhëna jepen më poshtë në udhëzues.

Rëndësia e statistikave gjinore njihet gjithashtu në ligjet për barazinë gjinore në Ballkanin Perëndimor, të cilët kërkojnë që të gjitha të dhënat dhe informacionet statistikore të mbledhura, regjistruara dhe përpunuara në autoritetet dhe institucionet publike të të gjitha niveleve duhet të ndahen sipas seksit.

Mësimet kryesore

- Mbledhja e të dhënave me ndjeshmëri gjinore është mbledhja dhe kategorizimi sistematik i të dhënave që llogarisin përvojat dhe rreziqet specifike me të cilat përballen gratë dhe burrat në lidhje me armët e zjarrit dhe krimet me armë zjarri.
- Statistikat gjinore duhet të pasqyrojnë në mënyrë të saktë mënyrën se si burrat dhe gratë i përjetojnë modelet e veprave penale dhe viktimizimit, rreziqet specifike me të cilat përballen për sa i përket armëve të zjarrit, veçanërisht në lidhje me dhunën me bazë gjinore, si edhe modelet e shpërndarjes së armëve të zjarrit.
- Statistikat gjinore përfshijnë të dhënat e ndara sipas seksit, të dhënat që lidhen specifikisht me gratë ose burrat, dhe të dhënat që pasqyrojnë problematikat gjinore.
- Për FFP-të, mbledhja dhe analizimi i të tre llojeve të të dhënave është një lloj e rëndësishme.
- Duke integruar këto komponentë, mbledhja e të dhënave me ndjeshmëri gjinore siguron që politikat dhe ndërhyrjet të trajtojnë në mënyrë efektive nevojat dhe përvojat e ndryshme të.



4. Analiza gjinore

Analiza gjinore është një proces analitik sistematik që përdoret për të identifikuar, kuptuar dhe përshkruar aspektet gjinore të një problematike specifike, dinamikat e saj gjinore, si dhe rëndësinë e roleve gjinore dhe dinamikat e pushtetit në një kontekst të caktuar.⁹

Përmes përdorimit të të dhënave të ndara sipas seksit dhe statistikave gjinore, **analiza gjinore ofron informacionet dhe rekomandimet e nevojshme për të integruar një perspektivë gjinore në politikat, programet dhe veprimtaritë (EIGE)**. Realizimi i një analize gjinore mundëson zhvillimin e ndërhyrjeve që trajtojnë pabarazitë gjinore dhe plotësojnë nevojat e ndryshme të burrave dhe grave.

Analiza gjinore shqyrton dallimet cilësore mes grave dhe burrave në një kontekst specifik. Ajo përmirëson kuptimin që ne kemi për rolet dhe pozicionet e burrave dhe grave në një fushë të caktuar, duke qartësuar rolet dhe dinamikat e tyre të pushtetit në kontekstin e komunitetit të gjerë. Duke analizuar këto marrëdhënie, role dhe struktura pushteti, analiza gjinore identifikon faktorët që kontribuojnë në cenueshmëri. Kjo qasje ndihmon në shmangien e supozimeve të gabuara dhe garanton që ne të mos hamendësojmë që të gjithë do të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga një ndërhyrje. Ajo thekson mënyrën se si burrat dhe gratë mund të ndikohen në mënyra të ndryshme nga rrethanat e tyre ose mund të kontribuojnë në mënyra të ndryshme për përmirësimin e situatës së tyre. Këto njohuri janë thelbësore për projektimin e programeve efektive.¹⁰

Në kontekstin e armëve të vogla, analiza gjinore është mjeti kryesor i përdorur për të identifikuar se si dinamikat dhe modelet gjinore lidhen me kriminalitetin me armë zjarri, dhe rreziqet specifike me të cilat gratë dhe burrat përballen në këtë aspekt.¹¹

Brenda objektivit të FFP-së, qëllimi i analizës gjinore është të identifikojë dhe shpjegojë modelet gjinore dhe të ekzaminojë ndikimin e normave, roleve dhe dinamikave gjinore lidhur me:

- Modelet e veprave penale,
- Rrugët drejt krimit, duke përfshirë ndikimin e roleve dhe pritshmërive gjinore,
- Rreziqet dhe faktorët mbrojtës në kontekstin e kriminalitetit me armë zjarri,
- Dhunën me armë zjarri dhe rolin e armëve të zjarrit në dhunën në familje,
- Kërkesën dhe shpërndarjen e armëve të zjarrit të ligjshme dhe të jashtëligjshme, si edhe llojet e municioneve të përdorura.

Në këtë mënyrë, analiza gjinore synon të kuptojë rreziqet specifike me të cilat gratë dhe burrat përballen, të kuptojë më mirë natyrën, masën, rëndësinë dhe shpeshhtësinë e kriminalitetit me armë zjarri, të **ekzaminojë shkaqet kryesore të tyre**, dhe të sigurojë që nevojat e grave dhe burrave të identifikohen dhe trajtohen në të gjitha fazat e ciklit të politikës dhe operacional. Kësisoj, analiza gjinore kontribuon në përmirësimin e përgjegjshmërisë gjinore në operacione, politika dhe legjislacion.

⁹ UNDP, Si të realizohet një analizë gjinore në programet kombëtare: Një udhëzues i shpejtë për stafin e UNDP-së.

¹⁰ UNSDG, 2019, Gender Mainstreaming.

¹¹ UNODA, 2022, Manuali i trajnimit për integrimin gjinor në kontrollin e AVL-ve, faqja 69.

Si funksionon analiza gjinore?

Analiza gjinore mundësohet nga mjetet e specializuara analitike dhe mund të realizohet në çdo fazë për të përmirësuar kuptimin dhe efektivitetin e operacioneve dhe politikave. Ky proces përfshin qasje dhe metodologji të ndryshme. Është zhvilluar një paketë gjithëpërfshirëse me metoda praktike, të tilla si manualë, lista kontrolli dhe udhëzime për analizën gjinore. Këto burime janë gjerësisht të disponueshme dhe mund të personalizohen për kontekstin specifik në të cilin kryet analiza, duke siguruar përkatësi dhe përshtatshmëri për ambiente dhe objektiva të ndryshme.

Zakonisht, analiza gjinore është një proces që përfshin disa hapa:

1. Mbledhja e të dhënave,
2. Identifikimi dhe shpjegimi i modeleve gjinore në një kontekst specifik, që ndihmon për të kuptuar modelet e ndryshme dhe pasojat e këtyre dallimeve,
3. Përdorimi i gjetjeve për të informuar politikën dhe operacionet.

Analiza gjinore varet nga cilësia dhe sasia e të dhënave dhe informacioneve me ndjeshmëri gjinore të ndara sipas seksit dhe moshës. Ato janë thelbësore për çdo analizë gjinore, pasi ofrojnë bazën e provave për projektimin, zbatimin dhe monitorimin e programeve të qëndrueshme, efektive, me përgjegjshmëri gjinore për armët e vogla.¹²

4.1 Analiza gjinore dhe analiza e krimit

Në kontekstin e punës së FFP-ve, analiza gjinore lidhet ngushtë me analizën e krimit dhe e mbështet atë duke identifikuar problemet e përsëritura, duke u dhënë përparësi atyre që kanë nevojë të trajtohen, duke kuptuar faktorët kontribuues, duke zhvilluar dhe zbatuar zgjidhje të personalizuara, si dhe duke vlerësuar efektivitetin e ndërhyrjeve. Si rrjedhojë, për FFP-të analiza gjinore nuk duhet të shihet e ndarë nga analiza e krimit, por si një pjesë integrale e saj. Një analizë krimi që e integron gjininë si një kategori të rëndësishme analitike.

Në këtë kuptim, analiza gjinore është në përputhje me analizën e inteligjencës kriminale dhe e përmirëson atë duke e konvertuar në studim të modeleve dhe tendencave të krimit me synim zgjidhjen e krimeve dhe parandalimin e ripërsëritjes së tyre.¹³ Zbatimi i perspektivës gjinore në mbledhjen dhe analizën e informacionit hedh dritë mbi shenjat e paqëndrueshmërisë që mund të jenë anashkaluar. Analiza gjinore është veçanërisht e dobishme që shërbimet e inteligjencës të kuptojnë marrëdhëniet sociale, rrjetet sociale dhe dinamikën e dhunës dhe kriminalitetit.¹⁴

¹² Po aty., faqe 50.

¹³ Council of Europe 2002, Crime Analysis

¹⁴ DCAF, 2020, Intelligence and Gender.


4.2 Nga të dhënat në inteligjencë: roli i analizës gjinore

Analiza gjinore është thelbësore për transformimin e të dhënave të papërpunuara në inteligjencë domethënëse, duke përfshirë të dhënat mbi armët e zjarrit dhe kriminalitetin me armë zjarri. Ajo ofron një kuptim më gjithëpërfshirës të problematikave specifike duke i ekzaminuar të dhënat nga një perspektivë gjinore dhe identifikuar tendencat, modelet, rreziqet, dinamikat dhe ndikimet.

Siç tregohet në figurën e mëposhtme, mbledhja e të dhënave me ndjeshmëri gjinore duhet të jetë një pjesë integrale e aktiviteteve të mbledhjes së të dhënave të FFP-ve, me përfshirjen sistematike të seksit dhe moshës (dhe mundësisht kategori të tjera, siç është diskutuar më herët) si variabla gjatë mbledhjes së të dhënave për individët. Kjo qasje përmirëson cilësinë e të dhënave të mbledhura.

Kur të dhënat e mbledhura organizohen dhe ndahen sipas seksit dhe moshës, ato transformohen në informacion që ofron kuptim dhe kontekst, duke shfaqur ndikimet ose përvojat e ndryshme të grave dhe burrave me armët e zjarrit.

Zbatimi i mëtejshëm i analizës gjinore ndihmon në identifikimin e modeleve gjinore dhe shkaqet e tyre kryesore, duke dhënë gjithashtu rekomandime për vendimmarrjen. Ky proces i shndërron të dhënat dhe informacionin në inteligjencë konkrete që është domethënëse dhe ka përgjegjshmëri gjinore. Duke zbuluar modelet e krimit, identifikuar tendencat, përcaktuar problemet dhe ofruar rekomandime të mbështetura në fakte, analiza gjinore luan një rol thelbësor në trajtimin e krimit me armë zjarri në mënyrë efektive.



Analiza gjinore mbështet analizën taktike, e cila përqendrohet në incidentet kriminale të kohëve të fundit për të identifikuar modelet dhe zhvilluar pistat, dhe analizën strategjike afatgjatë, e cila integron faktorë më të gjerë socialë-demografikë për

të shfaqur tendencat afatgjata të **krimit**.

Si përfundim, sa më e detajuar të jetë analiza, aq më e mirë do të jetë tabloja e inteligjencës. **Analiza gjinore e ndërlidhur**¹⁵ ekzaminon se si aspekte të ndryshme të identitetit të një personi, përveç seksit dhe moshës, kombinohen për të formësuar përvojat dhe sfidat e tyre. Ajo tregon se si faktorët e mbivendosur mund të krijojnë rreziqe ose disavantazhe specifike. Kjo qasje ndihmon të sigurojë që politikat dhe programet të trajtojnë nevojat e grupeve të ndryshme, veçanërisht të atyre që përballen me forma të ndryshme disavantazhesh.

4.3 Udhëzimet hap pas hapi për integrimin e analizës gjinore në veprimtaritë e FFP-ve

Metodologjia e propozuar e përmbledhur më poshtë bazohet në qasjet dhe mjetet gjerësisht të testuara të SEESAC, duke përfshirë *Instrumentin praktik për integrimin e perspektivës gjinore në kuadrot ligjorë dhe të politikave për AVL-të, Udhëzimet për analizën gjinore të legjislacionit dhe politikave përkatëse për kontrollin e armëve të vogla*, si edhe në përvojën e gjerë të SEESAC në realizimin e analizave gjinore në kontekstin e kontrollit të AVL-ve. Gjithashtu, ajo mbështetet në një gamë gjithëpërfshirëse burimesh, duke përfshirë listat e kontrollit, udhëzimet për mbledhjen e të dhënave, dhe metodologjitë e analizës gjinore si Metoda 4R.¹⁶ Për më tepër, ajo integron informacione kyçe nga *Trajnimi mbi aftësitë e të menduarit kritik dhe kapacitet analitike dhe Trajnimi i analistëve për Njësitë Qendrore për Armët e Zjarrit* të ofruar nga SEESAC në vitin 2022 dhe 2024. Duke u bazuar në këto themele, mjetet janë personalizuar me kujdes për të qenë në përputhje me rolet dhe përgjegjësitë specifike të FFP-ve, duke siguruar rëndësinë e tyre praktike dhe efektivitetin.

Hapi 1. Mbledhja e të dhënave - Marrja e informacionit për pozicionin e grave dhe burrave.

Hapi 2. Identifikimi i modeleve gjinore - Analizimi i të dhënave ekzistuese për të identifikuar modelet specifike gjinore.

Hapi 3. Analizimi i shkaqeve kryesore - Shqyrtimi i faktorëve pas modeleve të identifikuara.

Hapi 4. Përgjigja ndaj modeleve të identifikuara - Propozimi i masave për të trajtuar modelet e identifikuara gjinore.

Hapi 5. Konsolidimi i një tabloje inteligjence me përgjegjshmëri gjinore.

Hapi 6. Monitorimi i tendencave dhe vlerësimi i përgjigjes.

¹⁵ United Nations Inter-Agency Network on Women and Gender Equality, 2025, Intersectionality Informed Gender Analysis Toolkit.

¹⁶ Raportet Zyrtare të Qeverisë së Suedisë, 2007, Manuali për Integrimin Gjinor - Një libër me metoda praktike nga Komiteti Suedez për Mbështetjen e Integritimit Gjinor (JämStöd).

Metodologjia e propozuar organizohet në gjashtë hapa të ndërlidhura dhe mbështetet ngushtë në aftësitë e përdorura nga FFP-të në punën e tyre, si rrahja e mendimeve, të menduarit kritik, zhvillimi i hipotezës dhe testimi.

Për të realizuar analizën gjinore, FFP-ja duhet të fillojë të hulumtojë mbi problematikën aktuale dhe të identifikojë nëse agjencitë e tjera kanë hasur dhe trajtuar një sfidë të ngjashme ose nëse hulumtuesit e kanë studiuar. Shqyrtimi i mënyrës se si e kanë analizuar problemin, masat që kanë marrë dhe më me rëndësi, cilat prej përgjigjeve të tyre ishin efektive dhe cilat jo, mund të ofrojnë informacion të vlefshëm. Të mësuarit nga përpjekjet e të tjerëve i mundëson FFP-së të zhvillojë hipoteza të dobishme për t'u testuar gjatë trajtimit të problematikës së tyre.¹⁷

17 Clark, Ronald V., and John E. Eck, 2016, *Crime Analysis for Problem Solvers in 60 Small Steps*, Washington, DC: Office of Community Oriented Policing Services.

Hapi 1: Mbledhja e të dhënave - marrja e informacionit për pozicionin e grave dhe burrave

Objekti: Të mblidhen dhe regjistrohen sistematikisht të dhëna të ndara sipas seksit dhe statistika specifike gjinore të lidhura me armët e zjarrit, kriminalitetin me armë zjarri dhe problematikën specifike që po trajtohet. Ky hap siguron vizibilitetin e shqetësimeve gjinore, formon themelin për analizën e bazuar në fakte, dhe mbështet zhvillimin e strategjive dhe ndërhyrjeve efikase dhe me përgjegjshmëri gjinore.

Statistikat gjinore dhe të dhënat e ndara sipas seksit janë parakushte për të kuptuar aspektet gjinore të armëve të zjarrit dhe kriminalitetit me armë zjarri, dhe formojnë bazën për përgjigjet taktike dhe strategjike të bazuara në fakte. Nëse këto të dhëna nuk janë të disponueshme, shqetësimet gjinore do të mbeten të padukshme dhe kuptimi i problemit mund të jetë i papërshtatshëm, duke kufizuar në këtë mënyrë efektivitetin e përgjigjeve operacionale.

Pa informacionin mbi rreziqet specifike me të cilat përballen gratë dhe burrat në lidhje me armët e zjarrit, dhe dallimet në nevojat e tyre të sigurisë që duhet të trajtohen, këto problematika mund të anashkalohen.

Duke qenë se FFP-ja shërben si një arkiv për inteligjencën e lidhur me armët e zjarrit, dhe mbledh dhe integron inteligjencë gjithëpërfshirëse, të përditësuar dhe me përgjegjshmëri gjinore, hapi i parë është që të siguroni që:

- a) **Kur merrni ose regjistroni informacion për një incident, aksident ose ngjarje individuale** që përfshin një armë, komponent kryesor, municion, ose pjesë municioni që janë shtënë, përdorur, ose gjetur, FFP-ja duhet të sigurojë që në grupin e të dhënave të regjistrohen të paktën të dhënat e mëposhtme:
- Seksi dhe mosha e autorit(ëve)
 - Seksi dhe mosha e viktimës(ave)
 - Marrëdhënia e viktimës dhe autorit(ëve) (për shembull, partnerë intimë, anëtarë të familjes, të njohur, fqinjë, autor tjetër që viktima e njeh, autor që viktima nuk e njeh, marrëdhënie e panjohur mes viktimës dhe autorit)
 - Rezultati për viktimën(at) (për shembull, vvarë, lënduar, kërcënuar, asnjëra prej këtyre)
 - Rezultati për autorin(ët) (për shembull, arrestuar, pa kapur, lënduar, vvarë)
 - Informacioni për llojin e incidentit, duke siguruar që dhuna në familje të përfshihet në klasifikimin e incidenteve
 - Seksi dhe mosha e çdo individi tjetër të përfshirë duhet të regjistrohet dhe futet në bazën e të dhënave

- b) **Të siguronit që i njëjti grup të dhënash të regjistrohet kur informacioni kërkohet nga bazat e tjera të të dhënave të agjencive ligjzbatuese** (si për shembull, raportet e incidenteve, raportet e inteligjencës kriminale, raportet e krimeve, raportet e kriminalistikës, etj.).

Në këto situata, FFP-ja duhet të sigurohet që të dhënat thelbësore të lidhura me veprën penale dhe viktimizimin, të renditura poshtë pikës "a" të mblidhen dhe përpilohen.

- c) Gjithashtu, siç është theksuar, **të dhënat e mbledhura duhet të dokumentojnë problematikat kryesore gjinore siç është diskutuar më parë**, veçanërisht në lidhje me:

- veprën penale,
- viktimizimin dhe rreziqet specifike gjinore me të cilat përballen gratë dhe burrat në lidhje me armët e zjarrit,
- përdorimin e armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës me bazë gjinore,
- zotërimin dhe kërkesën për armët e zjarrit.

- d) **Për sa i përket të dhënave nga bazat e të dhënave të lejeve dhe regjistrimit të armëve të zjarrit, FFP-ja duhet të sigurojë që të disponohen të dhënat e mëposhtme:**

- Të dhënat e ndara sipas seksit dhe moshës për mbajtësit e lejeve të armëve të zjarrit.
- Të dhënat e ndara sipas seksit dhe moshës për aplikantët e rinj të lejeve për armë zjarri.
- Të dhënat e ndara sipas seksit për mbajtësit e lejeve të armëve të zjarrit dhe për ata të cilëve u është revokuar leja.
- Të dhënat e ndara sipas seksit dhe moshës për zotëruesit të cilët i kanë humbur ose ua kanë vjedhur armët e zjarrit.
- Të dhënat e ndara sipas seksit dhe moshës për aplikantët e lejeve për armë zjarri të cilëve u është refuzuar kërkesa, duke përfshirë arsyen e refuzimit (si dhuna në familje).
- Të dhënat e ndara sipas seksit dhe moshës për personat të cilëve u janë sekuestruar ose konfiskuar armët e zjarrit.

- e) **Identifikoni burime të tjera të rëndësishme të të dhënave në çdo kontekst që mund ta mbështesin FFP-në dhe të ndihmojnë në zhvillimin e një tabloje inteligjence me përgjegjshmëri gjinore.**

Këto burime mund të përfshijnë:

- **Platformën e Monitorimit të Dhunës me Armë (AVMP)**, të përdorur nga SEESAC, e cila monitoron sistematikisht incidentet me armë zjarri në Evropën Juglindore. Nga viti 2014, ajo ka mbledhur të dhëna të detajuara nga Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kosova, Moldavia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia. Të dhënat nga AVMP-ja mblidhen çdo ditë nga një kombinim burimesh zyrtare, duke përfshirë faqet e internetit të institucioneve ligjzbatuese dhe

ministrive të brendshme, si edhe nga mediat online dhe të shkruara. Të dhënat mbi incidentet me armë zjarri kategorizohen në përputhje me përkufizimet e standardizuara për të garantuar konsistencë dhe krahasueshmëri ndërmjet juridiksioneve dhe periudhave të raportimit. Çdo incident shqyrtohet dhe analizohet duke përdorur një metodologji të zhvilluar nga SEESAC. AVMP-ja ofron të dhëna për llojin e incidentit, armët e zjarrit të përdorura, seksin e viktimës dhe autorit, marrëdhënien e tyre, vendndodhjen e incidentit, dhe variabla të tjera. Analiza përfshin gjetjet kryesore nga raportet e *Monitorimit të Dhunës me Armë - "In Focus" lidhur me incidentet me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje në EJL të SEESAC*, që mbulojnë rastet nga viti 2019 e tutje. AVMP-ja gjeneron vazhdimisht të dhëna të ndara sipas seksit dhe moshës dhe ofron informacione për incidentet individuale dhe të dhëna të agreguara nga pikëpamja statistikore.

- **Bazat e të dhënave të zyrave statistikore të juridiksioneve.** TKëto baza të dhënash ofrojnë burime të vlefshme të të dhënave të agreguara për shumë problematika të rëndësishme për FFP-të, si për shembull:
 - Statistika gjyqësore, që japin të dhëna për autorët e rritur dhe të mitur të veprave penale, duke përfshirë veprat me armë zjarri. Këto statistika ofrojnë informacion bazë mbi veprat penale të kryera nga autorë të mitur dhe të rritur: individët e raportuar, të akuzuar dhe dënuar sipas llojit të veprës penale, seksit, moshës dhe sanksioneve penale. Të dhënat mbliidhen përmes anketave statistikore të rregullta të mbështetura në pyetësorët individualë që plotësohen nga prokuroritë dhe gjykatat kompetente.
 - Raportet për vdekjet e dhunshme që ofrojnë të dhëna për vdekjet e dhunshme (vetëvrasjet, vrasjet, vdekjet aksidentale) sipas Klasifikimit statistikor ndërkombëtar të sëmundjeve dhe problemeve shëndetësore të lidhura me to, dhe ofrojnë gjithashtu të dhëna për vdekjet e dhunshme nga armët e zjarrit.
- **Bazat e të dhënave të organizatave të tjera ndërkombëtare,** si bazat e të dhënave të UNODC-së,
- **Të dhënat e mbledhura nga organizatat e shoqërisë civile.**

f) Identifikoni kur të dhënat mungojnë, ose kur duhen të dhëna të tjera.

FFP-të duhet të vlerësojnë grupet e tyre aktuale të të dhënave për të identifikuar ku mungojnë të dhënat me ndjeshmëri gjinore ose ku duhen të dhëna shtesë. Ato duhet të zbatojnë procedura të standardizuara për të siguruar që mbledhjet e ardhshme të të dhënave të përfshijnë informacione thelbësore të tilla si gjinia, mosha dhe marrëdhënia mes viktimës dhe autorit, si edhe detaje të ngjashme. Kur vijohet të ketë mungesa kritike të dhënash, FFP-të do të angazhohen me subjekte të tjera që mbledhin të dhëna të rëndësishme për t'i trajtuar këto nevoja në mënyrë efektive dhe efikase.

Kutia 2: Anketat e armëve të vogla dhe të lehta 2012-2016 dhe Faktet e shpejta mbi gjininë dhe AVL-të

Në vitin 2017, SEESAC ngriti një grup pune rajonal, të përbërë nga përfaqësues të shtatë Komisioneve

të AVL-ve në rajon. Grupit iu caktua detyra e zhvillimit dhe dakordësimin të një metodologjie të

standardizuar për realizimin e një ankete rajonale të AVL-ve. Të dhënat për shpërndarjen dhe ndikimin e AVL-ve u mbledhën dhe analizuan me anë të pyetësorëve të standardizuar për shpërndarjen dhe ndikimin e AVL-ve. Ky proces i mbledhjes së të dhënave u koordinua nga Komisionet e AVL-ve, me mbështetjen teknike nga SEESAC. Pyetësorët përfshinin pyetje të standardizuara të projektuara për të siguruar mbledhjen e informacioneve të sakta dhe të përditësuara, duke përmirësuar koherencën, standardizimin dhe krahasueshmërinë e të dhënave në rajon.


Kryesisht, të gjitha të dhënat e mbledhura mbi individët janë ndarë sipas seksit dhe moshës, duke bërë të mundur një analizë gjithëpërfshirëse me përgjegjshmëri gjinore të shpërndarjes dhe ndikimit të AVL-ve. Kjo qasje ofroi informacione kritike për ndikimet e diferencuara mbi grupe të ndryshme demografike, duke kontribuar ndjeshëm në politikëbërjen e bazuar në prova, veçanërisht në zhvillimin e strategjive dhe planeve të veprimit për kontrollin e AVL-ve.

Anketat regjistruan në mënyrë gjithëpërfshirëse të dhënat e ndara sipas seksit dhe moshës mbi pronësinë e armëve të zjarrit, shtysat për blerjen e armëve të zjarrit, për personelin e sektorit të sigurisë të autorizuar për mbajtjen e armëve të zjarrit si edhe për viktimat dhe autorët e veprave penale të lidhura me AVL-të. Ato gjithashtu trajtuan aspekte specifike gjinore, si lidhjen mes armëve të zjarrit dhe dhunës nga partneri intim ose dhunës në familje. Në këtë mënyrë, anketat theksuan ndikimet e ndryshme gjinore të AVL-ve te burrat dhe gratë, si edhe dinamikat më të gjera gjinore rreth

keqpërdorimit të armëve të zjarrit dhe kërkesës për to. Kjo metodologji e shëndoshë tregon se si integrimi i qasjeve me ndjeshmëri gjinore në mbledhjen e të dhënave mund të udhëheqë zhvillimin e zgjidhjeve holistike dhe efektive për politikën. Gjetjet e anketave u përdorën gjerësisht në zhvillimin e strategjive për kontrollin e AVL-ve në rajon.


Bazuar në këto të dhëna, SEESAC zhvilloi serinë e *Fakteve të shpejta mbi gjininë dhe armët e vogla*, që dokumenton lidhjet e ndryshme mes gjinisë dhe AVL-ve në Evropën Juglindore. Seria parashton rreziqet specifike me të cilat përballen gratë dhe burrat në lidhje me armët e zjarrit, duke ofruar një pamje të përgjithshme të të dhënave të ndara sipas seksit mbi pronësinë, aksesin, kërkesën dhe ndikimin e armëve të zjarrit, duke përfshirë keqpërdorimin e tyre në kontekstet e dhunës në familje. Duke e përmirësuar aksesin në këto të dhëna, *faktet e shpejta* synojnë të rrisin njohuritë dhe ndërgjegjësimin mes profesionistëve dhe publikut të përgjithshëm në lidhje me aspektet me natyrë thellësisht gjinore të armëve të vogla. Seritë shërbejnë gjithashtu si një mjet praktik dhe i bazuar në fakte për politikëbërësit, duke mbështetur integrimin e gjinisë në legjislacionin dhe politikën për kontrollin e armëve të vogla.

Të gjitha produktet e njohurive, duke përfshirë pyetësorët e anketimit për AVL-të, janë të disponueshme në bazën e njohurive të SEESAC rreth AVL-ve.




**GENDER AND
SMALL ARMS**

: FAST FACTS



**THE MISUSE OF
FIREARMS IN
DOMESTIC VIOLENCE
IN SOUTH EAST
EUROPE**

: FAST FACTS



**MEN AND
FIREARMS
IN SOUTH EAST
EUROPE**

: FAST FACTS

Hapi 2: Inteligjenca me përgjegjshmëri gjinore - Identifikimi i modeleve gjinore

Objektivi: Të identifikohen modelet gjinore në një çështje specifike të lidhur me armët e zjarrit duke përdorur specifikat gjinore dhe të dhënat e ndara sipas seksi.

Në kontekstin e këtij udhëzuesi, modelet gjinore i referohen tendencave ose sjelljeve të përsëritura dhe sistematike të lidhura me përvojat e grave dhe burrave me armët e zjarrit, duke përfshirë përdorimin dhe keqpërdorimin e tyre, ndikimin dhe ekspozimin ndaj dhunës me armë, rreziqet dhe viktimizimin, si edhe pronësinë dhe kërkesën për armë zjarri. Këto modele tregojnë që situata dhe përvojat specifike të grave dhe burrave nuk janë të rastësishme ose të izoluar, por formësohen nga faktorë më të gjerë dhe të rrënjosur socialë, kulturorë, ekonomikë, institucionalë dhe të lidhur me sigurinë, duke përfshirë kontrollin dhe disponueshmërinë e armëve të zjarrit.

Kur analizohen, statistikat gjinore dhe të dhënat e ndara sipas seksit mund të tregojnë dallimet në pozicionet e grave dhe burrave që vijnë nga rolet dhe pritshmëritë gjinore. Në këtë hap, FFP-ja duhet të përdorë statistikat gjinore të disponueshme për të identifikuar modelet gjinore mbizotëruese dhe trajtuar pyetjen: Cilat janë modelet gjinore që mund të vërehen në këto të dhëna?

Nëse statistikat gjinore mblidhen ose disponohen, ato bëjnë të mundur identifikimin e modeleve gjinore mbizotëruese, duke e bërë më të lehtë për t'i shndërruar të dhënat e papërpunuara në informacion, dhe si rrjedhojë, në inteligjencë. Në këtë fazë, FFP-ja duhet të mbështetet në teknikat e rrahjes së mendimeve dhe të të menduarit kritik për të identifikuar tendencat.

Pyetjet orientuese për të drejtuar analizën dhe lehtësuar identifikimin e modeleve mund të përfshijnë:

Viktimizimi dhe rreziqet

1. *Cila është situata aktuale për gratë dhe burrat për sa i përket çështjeve specifike lidhur me armët e zjarrit dhe kriminalitetin me armë zjarri që po analizohen?*
2. *Cilat janë tendencat e vërejtura të viktimizimit për burrat dhe për gratë? Si ndikojnë problematikat e lidhura me armët e zjarrit të gratë krahasuar me burrat:*
 - Sa gra dhe sa burra ka mes viktimave?
 - Si ndryshojnë kontekstet e dhunës me armë zjarri për gratë dhe burrat? Cilat lloje incidentesh (për shembull dhuna në familje, mosmarrëveshjet në publik, aktiviteti kriminal) paraqesin rrezikun më të madh për gratë? Po për burrat?
 - Në cilin prej këtyre incidenteve keqpërdoren më shpesh armët e zjarrit kundrejt grave dhe burrave përkatësisht?
3. *Si ndryshojnë rreziqet dhe llojet e viktimizimit të lidhura me keqpërdorimin e armëve të zjarrit mes grave dhe burrave? Kush paraqet rrezik më të madh për gratë, dhe*

kush paraqet rrezik më të madh për burrat?

4. *A ka grupe specifike grash ose burrash (për shembull meshkujt e rinj në moshë, gratë në zonat rurale) që janë më të cenueshme ndaj rreziqeve të lidhura me armët e zjarrit?*
5. *Çfarë roli luajnë armët e zjarrit në dhunën në familje ose në dhunën nga partneri intim krahasuar me llojet e tjera të dhunës?*
6. *Si ndikon dhuna me bazë gjinore me armë zjarri te gratë, në veçanti në kontekstet e dhunës nga partneri intim dhe të abuzimit në familje?*
7. *Cilat janë llojet më të zakonshme të armëve të zjarri që përdoren në incidentet e dhunshme kundër grave dhe burrave? A ka ndonjë ndryshim në statusin e tyre ligjor (të ligjshme ose të jashtëligjshme)?*

Veprat penale

1. *Sa gra dhe sa burra ka mes autorëve?*
2. *Si ndryshojnë modelet e veprave penale me armë zjarri mes burrave dhe grave për sa i përket llojeve të krimeve të kryera, rrethanave që rrethojnë krimet dhe faktorëve të tjerë të rëndësishëm?*
3. *A ka tendenca të lidhura me moshën ose faktorë të tjerë rreziku (për shembull, a kanë më shumë gjasa meshkujt e rinj në moshë që të kryejnë vepra penale me armë zjarri?) që duhet të trajtohen?*

Rast studimor: Armët e zjarrit dhe dhuna në familje në Ballkanin Perëndimor

Siç është përmendur më herët, Platforma e SEESAC për monitorimin e dhunës me armë ofron një grup gjithëpërfshirës të dhënash mbi incidentet me armë zjarri në Ballkanin Perëndimor. Për çdo incident të regjistruar, të dhënat për viktimat dhe autorët ndahen sipas seksit dhe moshës dhe dokumentohen sistematikisht në platformë, duke bërë të mundur një analizë të plotë gjinore. AVMP-ja gjithashtu ofron të dhëna mbi llojin e incidentit, rezultatet për viktimat dhe autorët, natyrën e marrëdhënies së tyre dhe llojin e armës së përdorur. Duke përdorur të dhëna nga AVMP-ja, SEESAC realizoi një analizë të thelluar mbi keqpërdorimin e armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje nga viti 2019 deri në vitin 2023, duke treguar se si analiza gjinore mund të përdoret për të zhvilluar një tablo gjithëpërfshirëse të inteligjencës.

Shembulli prezantohet përmes analizës me hapa:

Hapi 1: Mbledhja e të dhënave - marrja e informacionit për pozicionin e grave dhe burrave

1. Në total, kanë ndodhur 452 incidente me armë zjarri gjatë dhunës në familje, 2461 në kontekstin kriminal, 1375 në mosmarrëveshjet në publik, 888 në aksidente, gjueti ose të shtëna gjatë festimeve, 153 në mosmarrëveshjet me policinë, 2611 ishin të shtënat për shkaqe të papërcaktuara, dhe 6474 ishin konfiskimet e armëve.
2. Në të njëjtën periudhë, 152 njerëz janë vrarë në dhunën në familje, 144 në kontekstin kriminal, 135 në mosmarrëveshjet në publik, 64 në aksidente, të shtëna gjatë festimeve ose gjueti, 29 në të shtënat masive, 15 në mosmarrëveshjet me policinë dhe 142 të shtëna për shkaqe të papërcaktuara të klasifikuara si "të tjera".
3. Nëse të dhënat ndahen më tej sipas seksit të viktimës dhe llojit specifik të incidentit, numri i fataliteteve paraqitet si më poshtë:
 - Dhuna në familje: 93 gra dhe 59 burra.
 - - Konteksti kriminal: 12 gra dhe 131 burra.
 - - Mosmarrëveshjet në publik: 1 grua dhe 134 burra.
 - - Incidentet aksidentale: 7 gra dhe 57 burra.
 - - Të shtënat masive: 10 gra dhe 19 burra.
 - - Mosmarrëveshjet me policinë: 15 burra dhe 0 gra.
4. Në total, 267 autorë të incidenteve me armë zjarri në dhunën në familje ishin burra, dhe 7 ishin gra.
5. Nëse të dhënat mbi marrëdhënien e viktimës me autorin janë të disponueshme, kjo do ta lehtësonte edhe më shumë analizën dhe do na mundësonte të kuptonim më mirë rreziqet dhe dinamikat specifike të krimit me armë zjarri në këtë kontekst.
6. Në total, 71 gra dhe 2 burra janë vrarë me armë zjarri nga partnerët e tyre intimë, ndërsa 20 gra dhe 49 burra janë vrarë nga anëtarë të tjerë meshkuj të familjes.
7. Armët e brezit janë përdorur në 203 incidente; pushkët dhe shotganët në 71 incidente (55 prej të cilave përfshinin armët e gjuetisë); AVL të shumta janë dokumentuar në 47 incidente; dhe armë automatike ose ushtarake në 41 incidente. Lëndët plasëse janë raportuar në 12 incidente, dhe pistoletat me gaz dhe ato me ajër janë raportuar secila në 11 raste.
8. Në 174 incidente, janë përdorur armë të zotëruara në mënyrë të jashtëligjshme, ndërsa në 26 incidente, armët zotëroheshin në mënyrë të ligjshme. Për 252 incidente, informacioni mbi llojin e pronësisë nuk disponohej.

Hapi 2: Identifikimi i modeleve gjinore

Kur disponohen statistikat e ndara sipas gjinisë dhe informacioni për armët, bëhet i mundur identifikimi i modeleve të qarta gjinore. Në këtë fazë, rekomandohet që këto modele gjinore të përkufizohen në mënyrë të qartë dhe të saktë mbi bazën e të dhënave të disponueshme.

- Modeli 1: *Keqpërdorimi i armëve të zjarrit në dhunën në familje është raportuar më pak se në llojet e tjera të incidenteve.*
- Modeli 2: *Dhuna në familje përbën numrin më të lartë të vdekjeve me armë zjarri.*
- Modeli 3: *Gratë përbëjnë shumicën e viktimave të vdekjeve me armë zjarri.*
- Modeli 4: *Burrat janë më të rrezikuar në kontekstet kriminale dhe mosmarrëveshjet në publik, ndërsa gratë preken në mënyrë joproporcionale në kontekstet e dhunës në familje.*
- Modeli 5: *Në kontekstin e dhunës në familje, gratë janë më të rrezikuara nga partnerët intimë, ndërsa burrat kanë më shumë gjasa të jenë të rrezikuar nga anëtarët e tjerë meshkuj të familjes.*
- Modeli 6: *Armët e brezit janë përdorur më shpesh në incidentet e dhunës në familje, të ndjekura nga armët e gjuetisë.*
- Modeli 7: *Armët e jashtëligjshme janë përdorur më shpesh në dhunën në familje se sa armët e ligjshme. Megjithatë, informacioni për llojin e pronësisë më së shumti ka munguar.*

Hapi 3: Analizimi i shkaqeve kryesore - shqyrtimi i faktorëve pas modeleve të identifikuara

Objektivi: Të realizohet një analizë e thelluar mbi llojin e faktorëve kryesorë që kontribuojnë në modelet e vëzhguara gjinore në kriminalitetin dhe dhunën me armë zjarri. Ky hap mbështetet në gjetjet nga **Hapi 2** (identifikimi i modeleve gjinore) duke bërë pyetjen **“Pse ndodh kështu?”**, për të zbuluar shkaqet në themel të këtyre dallimeve dhe për të ofruar informacione me vlera praktike. Qëllimi është të kuptohen dinamikat gjinore, sociale dhe të lidhura me armët e zjarrit që udhëheqin këto modele dhe të zhvillohet një tablo gjithëpërfshirëse e inteligjencës.

Pyetje orientuese:

1. Në çfarë mase ndikojnë normat dhe rolet gjinore në llojin dhe shpeshtësinë e keqpërdorimit të armëve të zjarrit në një kontekst specifik, si për shembull dhuna në familje?
2. Çfarë roli luajnë armët e zjarrit në dinamikat e pushtetit (në kontekstin e dhunës në familje dhe nga partneri intim), dhe si ndikon kjo tek gratë dhe burrat në mënyrë joproporcionale?
3. Cili është roli i armëve të zjarrit në një problem specifik që po analizohet, si për shembull dhuna në familje? Si e rrisin armët e zjarrit rrezikun në dhunën në familje?
4. Si e formësojnë pabarazitë gjinore ekspozimin e grave dhe burrave ndaj dhunës me armë zjarri?

Rast studimor: Armët e zjarrit dhe dhuna në familje në Ballkanin Perëndimor

Analiza e SEESAC e përmendur më sipër, ka përdorur metodat sasiore por edhe cilësore (si për shembull diskutimet në grupet e fokusit dhe intervistat e thelluara) për të identifikuar **disa faktorë që shpjegojnë modelet e gjetura në Hapin 2:**

1. Prania e armëve të zjarrit redukton më tej nivelin tashmë të ulët të raportimit të dhunës në familje.
2. Gratë shpesh e shmangin raportimin e dhunës në familje, veçanërisht kur janë të përfshira armët e zjarrit, për shkak të frikës së përshkallëzimit dhe hakmarrjes nga abuzuesi.
3. Dhuna shpesh nuk raportohet në fazat e saj fillestare, që mund të çojë në pasoja edhe më të rënda për viktimat me kalimin e kohës.
4. Armët e zjarrit shërbejnë si mjet kërcënimi dhe kontrolli në marrëdhëniet abuzive, duke përforcuar pabarazitë e pushtetit dhe hierarkitë gjinore.
5. Gratë kanë më shumë gjasa ta raportojnë dhunën vetëm kur besojnë që jeta e tyre ose jetët e fëmijëve të tyre janë në rrezik të menjëhershëm.
6. Gjasat e një rezultati vdekjeprurës rriten për shkak të:
 - seriozitetit të lëndimeve të shkaktuara nga armët e zjarrit,
 - aftësisë së kufizuar të grave për të rezistuar ose për t'u arratisur,
 - gjasave më të pakta për ndërhyrje nga të tjerët, dhe
 - rrezikut më të madh që abuzuesi ta përdorë armën e zjarrit.

7. Në incidentet që përfshijnë armët e zjarrit të jashtëligjshme, viktimat shpesh nuk tregojnë informacione kritike nga frika e hakmarrjes ose nga pasojat e mundshme ligjore për autorin.
8. Normat kulturore që i lidhin armët e zjarrit me burrin dhe identitetin burror mund të shkurajojnë raportimin e dhunës në familje dhe të keqpërdorimit të armëve të zjarrit.
9. Abuzuesit shpesh i përdorin armët e zjarrit ose lëndët plasëse për të vendosur ose rivendosur kontroll mbi viktimat, veçanërisht kur ndjejnë që pushteti i tyre po vihet në dyshim.
10. Procedurat aktuale të vlerësimit të rrezikut për dhunën në familje shpesh nuk arrijnë që të marrin parasysh siç duhet rreziqet e paraqitura nga armët e zjarrit.
11. Procedurat e lejeve për armë zjarri nuk e marrin mjaftueshëm në konsideratë keqpërdorimin e mundshëm të armëve të zjarrit në situatat e dhunës në familje.

Hapi 4: Përgjigja ndaj modeleve gjinore të identifikuara

Objektivi: Të propozohen dhe zbatohen masa praktike që trajtojnë në mënyrë efektive modelet gjinore të identifikuara dhe shkaqet e tyre kryesore. Duke u mbështetur në analizën gjinore të zhvilluar në hapat e mëparshëm, kjo fazë përqendrohet në përdorimin e informacionit për të zhvilluar masa konkrete taktike dhe strategjike për të zgjidhur problemin. Rekomandimet që vijnë nga analiza gjinore mund të jenë reaguese ose parandaluese.

Për shembull, mbështetur në informacionet e marra në hapat e mëparshëm, rekomandimet e mundshme për agjencitë ligjzbatuese mund të përfshijnë:

- Sigurohuni që, në çdo rast të raportuar të dhunës në familje, prania e armëve të zjarrit të verifikohet gjithmonë pa përjashtim - pavarësisht nëse janë përdorur apo jo - dhe që oficeri përgjegjës të dokumentojë çdo informacion në lidhje me praninë ose përdorimin e armëve të zjarrit në raport.
- Sigurohuni që procedurat e vlerësimit të rrezikut të jenë miratuar dhe të zbatohen siç duhet dhe me shpejtësi për çdo rast të raportuar të dhunës në familje, siç kërkohet nga Konventa e Stambollit dhe legjisllacioni në fuqi në çdo juridiksion.
- Sigurohuni që vlerësimi i rrezikut të marrë parasysh të gjitha situatat specifike që përfshijnë armët e zjarrit, si për shembull: nëse autori ose një anëtar tjetër i familjes (duke përfshirë viktimën) zotëron ligjërisht një armë; nëse autori ose një anëtar tjetër i familjes mund të zotërojë një armë pa leje; nëse autori ka akses tek armët e zjarrit si pjesë e detyrave profesionale dhe është i trajnuar për përdorimin e tyre; ose nëse autori mund t'i aksesojë lehtësisht armët e zjarrit.

- Sigurohuni që çdo armë zjarri e zotëruar në mënyrë të ligjshme nga autori të sekuestrohet pa përjashtim në çdo incident të raportuar, siç kërkohet nga ligjet për armët dhe të dhunës në familje, si dhe të iniciohen procedurat përkatëse dhe të konfiskohen menjëherë armët pa leje.
- Sigurohuni që, në rastin e një incidenti të raportuar, çdo armë që mund të aksesohet lehtësisht nga një autor, si për shembull ato që zotërohen nga anëtarë të tjerë të familjes ose persona që banojnë në të njëjtën banesë, ose çdo armë tjetër lehtësisht e aksesueshme, të sekuestrohet menjëherë.
- Sigurohuni që oficerët e parë në vendngjarje (patrulla) të kenë akses të besueshëm, të menjëhershëm dhe 24/7 në bazat e të dhënave të përditësuara të regjistrimit të armëve të zjarrit për të mbështetur ndërhyrjet efektive dhe në kohën e duhur, duke trajtuar kufizimet aktuale në akses dhe besueshmëri.
- Sigurohuni që regjistri i armëve të jetë gjithëpërfshirës dhe i përditësuar, me të dhëna të sakta të të gjithë zotëruesve të armëve të zjarrit dhe të armëve të tyre të regjistruara. Duhet të kryhen kontrole të rregullta për të garantuar besueshmërinë e të dhënave të regjistrimit dhe pajtueshmërinë me rregulloret për armët e zjarrit.
- Përveç precedentëve penalë dhe kundërvajtjeve, sigurohuni që gjatë shqyrtimit të një kërkesë për marrjen e armëve të zjarrit, të merren në konsideratë regjistrat operacionale të policisë, si dhe çdo informacion mbi urdhrat e mbrojtjes dhe masat mbrojtëse të përkohshme.
- Aplikoni praktikën e njoftimit të anëtarëve të rrethit të ngushtë familjar, duke përfshirë partnerët, lidhur me çdo kërkesë të dorëzuar nga anëtari i familjes ose partneri për marrjen e një arme zjarri. Këto njoftime duhet të marrin në konsideratë rreziqet e sigurisë me të cilat mund të përballen anëtarët e familjes.
- Përmirësoni procedurat e verifikimit të së shkuarës duke integruar intervista të detyrueshme me anëtarët e familjes, përfshirë me partnerët intimë aktualë ose të mëparshëm, si dhe me miqtë, fqinjët apo bashkëpunëtorët, përpara miratimit apo rinovimit të lejes për armë zjarri.
- Duke pasur parasysh nivelin e përhapjes së keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje, garantoni që armët e përdorura në këto incidente të gjurmohen siç duhet dhe të ekzaminohen teknikisht me qëllim që këto njohuri të përdoren për të informuar zhvillimin e politikave dhe përgjigjen operacionale. Gjurmimi në mënyrë sistematike i çdo arme zjarri të sekuestruar mbështet tablonë e përgjithshme të inteligjencës për armët e zjarrit të jashtëligjshme, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Hapi 5: Konsolidimi i një tabloje inteligjence me përgjegjshmëri gjinore

Objektivi: Të kombinohen të gjitha gjetjet nga hapat e mëparshëm në një tablo inteligjence të unifikuar dhe praktike.

Kjo do t'i ndihmojë vendimmarrësit të marrin vendime të informuara dhe efektive që trajtojnë dinamikat gjinore të identifikuar dhe shkaqet kryesore të problemeve të lidhura me armët e zjarrit. Informacioni i mbledhur dhe analizuar në fazat e mëparshme, si për shembull të dhënat e ndara, modelet gjinore të identifikuar dhe informacionet për shkaqet kryesore të keqpërdorimit të armëve të zjarrit, shërben si bazë për këtë hap. Konsolidimi i këtyre të dhënave garanton një kuptim të qartë dhe të mbështetur në fakte të dinamikave gjinore në incidentet me armë zjarri. Ky kuadër i përsosur i inteligjencës mundëson përgjigje specifike dhe veprime strategjike për të trajtuar me efikasitet problematikat specifike gjinore të identifikuar.

Për ta arritur këtë, FFP-ja duhet:

- Të grumbullojë dhe përpilojë të gjitha të dhënat e mbledhura në hapin 1.
- Të theksojë modelet gjinore kyçe të identifikuar në hapin 2 dhe informacionet nga hapi 3 që tregojnë shkaqet kryesore që kontribuojnë në këto modele, veçanërisht sa i përket modeleve gjinore të viktimizimit, veprave penale, keqpërdorimit të armëve të zjarrit dhe rreziqeve.
- Të përfshijë masat e propozuara në hapin 4 për të trajtuar modelet e identifikuar.

Nëse ne konsolidojmë gjetjet tona dhe identifikojmë modelet gjinore, kjo do të ofrojë një tablo të shëndoshë të inteligjencës. Më poshtë gjeni një shembull se si mund të duket kjo inteligjencë:

Gjatë periudhës 2019–2023, janë vrarë me shumë persona në incidentet me armë zjarri të lidhura me dhunën në familje (152 në total - 93 gra dhe 59 burra) se në çdo kategori tjetër incidentesh të mbuluar nga Platforma e Monitorimit të Dhunës me Armë (AVMP), duke tejkaluar numrin e viktimave në kontekstet kriminale (144) dhe mosmarrëveshjet në publik (135). Pavarësisht se një numër i konsiderueshëm grash dhe burrash janë vrarë në kontekstin familjar (93 gra dhe 59 burra), ndikimi joproporcional i keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje te gratë është veçanërisht i dukshëm nëse i kategorizojmë viktimat nga armët e zjarrit sipas llojit të incidentit. Në rajon, 68,4% e grave të vrara me armë zjarri janë vrarë në kontekstin e dhunës në familje - një shifër thuajse tetë herë më e lartë se ajo e grave të vrara në aktivitetet kriminale. Gjatë të njëjtës periudhë, 10,9% e burrave të vrarë me armë zjarri në rajon janë vrarë nga anëtarët e tyre të familjes.

Në kontekstin e dhunës në familje, gratë dhe burrat përballen me rreziqe specifike gjinore. Gratë janë më të rrezikuara nga përdorimi i armëve të zjarrit nga partneri i tyre intim aktual ose i mëparshëm, ndërsa burrat janë më të rrezikuar nga anëtarët tjerë meshkuj të familjes.

Në Ballkanin Perëndimor, 50,7% e grave të vrara me armë zjarri janë vrarë nga partneri i tyre intim. Në të njëjtën periudhë, e njëjta statistikë vlen vetëm për 0,4% të burrave të vrarë me armë. Gratë kanë tre herë më shumë gjasa që të vriten nga partnerët intimë aktualë ose të kohëve të fundit, se sa nga ish-partnerët.

Numri i lartë i viktimave në rastet e dhunës në familje bie në kundërshtim me numrin relativisht të ulët të incidenteve të raportuara, çka nënvizon rreziqet specifike të lidhura me armët e zjarrit, të cilat rrisin gjasat e pasojave fatale.

Keqpërdorimi i armëve të zjarrit në dhunën në familje raportohet shumë më pak se sa llojet e tjera të incidenteve me armë zjarri, si për shembull ato që ndodhin në kontekstet kriminale, mosmarrëveshjet në publik, ose të shtënat për shkaqe të papërcaktuara. Gjatë periudhës 2019–2023, incidentet e lidhura me armët e zjarrit

në dhunën në familje përbënin vetëm 3,1% të të gjitha incidenteve të raportuara me armë zjarri, një tendencë e cila vijoi gjatë të gjithë periudhës së analizuar.

Armët e brezit janë përdorur në 203 incidente, pushkët dhe shotganët në 71 (duke përfshirë 55 armë gjuetie), AVL të shumta në 47 dhe armët automatike ose ushtarake në 41. Lëndët plasëse janë raportuar në 12 incidente, ndërsa pistoletat me gaz dhe ato me ajër janë raportuar secila në 11 raste.

Mes incidenteve të regjistruara, armët e jashtëligjshme janë raportuar më shpesh. Megjithatë, për shkak të nënraportimit të dhunës në familje, këto gjetje duhet të interpretohen me kujdes, pasi keqpërdorimi i armëve të zjarrit të zotëruara në mënyrë të ligjshme mund të jetë i nënraportuar, veçanërisht kur nuk përdoren për sulme ose kur rezultatet nuk janë kërcënuese për jetën.

Modelet e identifikuara mund t'i atribuohen disa faktorëve të ndërlidhur:

1. *Prania e armëve të zjarrit redukton më tej nivelin tashmë të ulët të raportimit të dhunës në familje.*
2. *Gratë shpesh e shmangin raportimin e dhunës në familje, veçanërisht kur janë të përfshira armët e zjarrit, për shkak të frikës së përshkallëzimit dhe hakmarrjes nga abuzuesi.*
3. *Dhuna shpesh nuk raportohet në fazat e saj fillestare, që mund të rezultojë në pasoja edhe më të rënda për viktimat me kalimin e kohës.*
4. *Armët e zjarrit shërbejnë si mjet kërcënimi dhe kontrolli në marrëdhëniet abuzive, duke përforcuar pabarazitë e pushtetit dhe hierarkitë gjinore.*
5. *Gratë kanë më shumë gjasa ta raportojnë dhunën vetëm kur besojnë që jeta e tyre ose e fëmijëve të tyre është në rrezik të menjëhershëm.*
6. *Gjasat e një rezultati fatal rriten për shkak të:*
 - seriozitetit të lëndimeve të shkaktuara nga armët e zjarrit,
 - aftësisë së kufizuar të grave për të rezistuar ose për t'u arratisur,
 - gjasave më të pakta për ndërhyrje nga të tjerët, dhe
 - rrezikut më të madh që abuzuesi ta përdorë armën e zjarrit.
7. *Në incidentet që përfshijnë armët e zjarrit të jashtëligjshme, viktimat shpesh nuk tregojnë informacione kritike nga frika e hakmarrjes ose nga pasojat e mundshme ligjore për autorin.*
8. *Normat kulturore që i lidhin armët e zjarrit me burrërinë dhe identitetin burrëror mund të shkurajojnë raportimin e dhunës në familje dhe të keqpërdorimit të armëve të zjarrit.*
9. *Abuzuesit shpesh i përdorin armët e zjarrit ose lëndët plasëse për të vendosur ose rivendosur kontroll mbi viktimën, veçanërisht kur ndjejnë që pushteti i tyre po vihet në dyshim.*
10. *Procedurat aktuale të vlerësimit të rrezikut për t'iu përgjigjur dhunës në familje shpesh nuk arrijnë që të marrin parasysh siç duhet rreziqet e paraqitura nga armët e zjarrit.*

11. Procedurat e lejeve për armë zjarri nuk e marrin mjaftueshëm në konsideratë keqpërdorimin e mundshëm të armëve të zjarrit në situatat e dhunës në familje.
12. Në situatat e konfliktit, armët e zjarrit mund të rrisin ndjeshëm rreziqet e dhunës me bazë gjinore dhe rrisin cenueshmërinë e grave.

Për të trajtuar këta faktorë, FFP-ja rekomandon sa më poshtë:

- Sigurohuni që, në çdo rast të raportuar të dhunës në familje, prania e armëve të zjarrit të verifikohet gjithmonë pa përjashtim - pavarësisht nëse janë përdorur apo jo - dhe që oficeri përgjegjës të dokumentojë çdo informacion në lidhje me praninë ose përdorimin e armëve të zjarrit në raport.
- Sigurohuni që procedurat e vlerësimit të rrezikut të jenë miratuar dhe të zbatohen siç duhet dhe me shpejtësi për çdo rast të raportuar të dhunës në familje, siç kërkohet nga Konventa e Stambollit dhe legjislacioni në fuqi në çdo juridiksion.
- Sigurohuni që vlerësimi i rrezikut të marrë parasysh të gjitha situatat specifike që përfshijnë armët e zjarrit, si për shembull: nëse autori ose një anëtar tjetër i familjes (duke përfshirë viktimën) zotëron ligjërisht një armë; nëse autori ose një anëtar tjetër i familjes mund të zotërojë një armë pa leje; nëse autori ka akses tek armët e zjarrit si pjesë e detyrave profesionale dhe është i trajnuar për përdorimin e tyre; ose nëse autori mund t'i aksesojë lehtësisht armët e zjarrit.
- Sigurohuni që çdo armë zjarri e zotëruar në mënyrë të ligjshme nga autori të sekuestrohet pa përjashtim në çdo incident të raportuar, siç kërkohet nga ligjet për armët dhe të dhunës në familje, si dhe të iniciohen procedurat përkatëse dhe të konfiskohen menjëherë armët pa leje.
- Sigurohuni që, në rastin e një incidenti të raportuar, çdo armë që mund të aksesohet lehtësisht nga një autor, si për shembull ato që zotërohen nga anëtarë të tjerë të familjes ose persona që banojnë në të njëjtën banesë, ose çdo armë tjetër lehtësisht e aksesueshme, të sekuestrohet menjëherë.
- Sigurohuni që oficerët e parë në vendngjarje (patrulla) të kenë akses të besueshëm, të menjëhershëm dhe 24/7 në bazat e të dhënave të përditësuara të regjistrimit të armëve të zjarrit për të mbështetur ndërhyrjet efektive dhe në kohën e duhur, duke trajtuar kufizimet aktuale në akses dhe besueshmëri.
- Sigurohuni që regjistri i armëve të jetë gjithëpërfshirës dhe i përditësuar, me të dhëna të sakta të të gjithë zotëruesve të armëve të zjarrit dhe të armëve të tyre të regjistruara. Duhet të kryhen kontrole të rregullta për të garantuar besueshmërinë e të dhënave të regjistrimit dhe pajtueshmërinë me rregulloret për armët e zjarrit.
- Përveç precedentëve penalë dhe kundërvajtjeve, sigurohuni që gjatë shqyrtimit të një kërkesë për marrjen e armëve të zjarrit, të merren në konsideratë regjistrat operacionalë të policisë, si dhe çdo informacion mbi urdhrat e mbrojtjes dhe masat mbrojtëse të përkohshme.
- Aplikoni praktikën e njoftimit të anëtarëve të rrethit të ngushtë familjar, duke përfshirë partnerët, lidhur me çdo kërkesë të dorëzuar nga anëtari i familjes ose partneri për marrjen e një arme zjarri. Këto njoftime duhet të marrin në konsideratë rreziqet e sigurisë me të cilat mund të përballen anëtarët e familjes.

- *Përmirësoni procedurat e verifikimit të së shkuarës duke integruar intervista të detyrueshme me anëtarët e familjes, përfshirë me partnerët intimë aktualë ose të mëparshëm, si dhe me miqtë, fqinjët apo bashkëpunëtorët, përpara miratimit apo rinovimit të lejes për armë zjarri.*
- *Duke pasur parasysh nivelin e përhapjes së keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje, garantoni që armët e përdorura në këto incidente të gjurmohen siç duhet dhe të ekzaminohen teknikisht me qëllim që këto njohuri të përdoren për të informuar zhvillimin e politikave dhe përgjigjen operacionale. Gjurmimi në mënyrë sistematike i çdo arme zjarri të sekuestruar mbështet tablonë e përgjithshme të inteligjencës për armët e zjarrit të jashtëligjshme, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.*

Hapi 6: Monitorimi i tendencave dhe vlerësimi i përgjigjes


Objektivi: Të sigurohet një qasje sistematike për monitorimin dhe vlerësimin e tendencave në aspektet gjinore të kriminalitetit të lidhur me armët e zjarrit.

Mbledhja e rregullt e të dhënave është thelbësore sepse tendencat bëhen të dukshme vetëm me kalimin e kohës nga një perspektivë afatgjatë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për aspektet gjinore të kriminalitetit me armë zjarri, që janë dukshëm të qëndrueshme dhe për këtë arsye kërkojnë një qasje afatgjatë dhe shumësektoriale.

Përveç ofrimit të një kuptimi më të përgjithshëm të kriminalitetit me armë zjarri, mbledhja e rregullt e të dhënave lehtëson vlerësimin e efikasitetit të masave të ndërmarra për të parandaluar kriminalitetin me armë zjarri dhe ndihmon në identifikimin e fushave që kanë nevojë për përmirësim. Përmes vlerësimit të vazhdueshëm të rezultateve të ndërhyrjes dhe mbledhjes e analizimit sistematik të të dhënave të ndara, ky hap synon të përmirësojë përpjekjet për parandalimin edhe përgjigjen, ndërkohë që pasuron me informacion zhvillimin e politikave të bazuara në fakte për të trajtuar dinamikat në zhvillim të dhunës në familje me armë zjarri.

Mësimet kryesore

- Analiza gjinore është mjete kryesor për identifikimin e mënyrës se si dinamikat dhe modelet gjinore lidhen me kriminalitetin me armë zjarri dhe të rreziqeve specifike me të cilat përballen gratë dhe burrat në këtë aspekt.
- Analiza gjinore është në përputhje me analizën e inteligjencës kriminale dhe e përmirëson atë duke shqyrtuar modelet dhe tendencat e krimit me synim zgjidhjen e krimeve dhe parandalimin e ripërsëritjes së tyre.
- Analiza gjinore është thelbësore për transformimin e të dhënave të papërpunuara në inteligjencë domethënëse dhe praktike.
- Metodologjia hap pas hapi ofron udhëzime të detajuara për FFP-të për sa i përket.



5. Përdorimi i analizës gjjinore në produktet analitike të njësive qendrore për armët e zjarrit

Analiza gjinore mund të përmirësojë produktet kryesore të FFP-së duke i mbështetur hetuesit dhe furnizuar me informacione planifikimin strategjik.

Përmes theksimit të aspekteve gjinore të:

- modeleve në veprat penale,
- rrugëve drejt krimit, duke përfshirë mundësitë dhe kufizimet, rolet dhe pritshmëritë gjinore,
- rreziqeve dhe faktorëve mbrojtës në kontekstin e kriminalitetit me armë zjarri,
- dhunës me armë zjarri dhe rolit të armëve të zjarrit në dhunën në familje,
- faktorëve që nxisin kërkesën për armë zjarri të ligjshme dhe të jashtëligjshme, analiza gjinore mund të përforcojë:
- vlerësimet operacionale që mbështesin hetimet kriminale dhe operacionet e inteligjencës kriminale,
- vlerësimet strategjike të inteligjencës që përshkruajnë shkallën dhe natyrën e kriminalitetit me armë zjarri, si
 - raportet mujore (të dhënat e ndara për viktimat, autorët, motivet e krimit, dhunën me bazë gjinore),
 - profilizimi i subjektit,
 - profilizimi i problemit,
 - analiza e tendencave,
- vlerësimet e kërcënimit.

Gjithashtu, FFP-të do të kontribuojnë në pasurimin me informacion të strategjisë për kontrollin e AVL-ve duke shpërndarë produktet e tyre të inteligjencës, që përfshijnë analizën e përshtatshme gjinore.

Rast studimor: Ekspozimi i meshkujve të rinj në moshë ndaj dhunës me armë zjarri - Përdorimi i analizës gjinore për profilizimin e problemit dhe të subjektit

Meshkujt e rinj në moshë janë zakonisht grupi demografik që ka gjasat më të larta të përfshihet në sjellje të rrezikshme dhe aktivitete kriminale, të cilat shpeshherë përfshijnë edhe përdorimin e armëve të zjarrit. Ata kanë më shumë gjasa të keqpërdorin armët e zjarrit se sa burrat e grupmohave të tjera, dhe në Ballkanin Perëndimor, pothuajse gjysma e incidenteve me armë zjarri kryen nga meshkujt e rinj në moshë.

Burrat e grupmohës 16 deri në 24 vjeç kanë shumë më tepër gjasa se ata të grupmohave të tjera që të raportojnë përvoja me armët e zjarrit gjatë kohëve të fundit. Ata janë gjithashtu më shumë të prirur se sa burrat e grupmohave të tjera të tregojnë se do të zotëronin një armë zjarri. Gjithashtu, 60,5% e burrave të grupmohës 16–24 vjeç besojnë se do të ndiheshin më të sigurt me një armë zjarri në shtëpi.

Tendenca që kanë meshkujt në mes ose në fund të adoleshencës dhe në të njëzetat dhe veçanërisht ata që janë të pamartuar dhe të papunë, për t'u përfshirë në konflikte të dhunshme për të zgjidhur çështje në dukje të parëndësishme, për të "ruajtur imazhin e tyre", për të dëmtuar një rival, ose për të rritur statusin e tyre social, zakonisht njihet me termin **sindroma e meshkujve të rinj**.¹⁸ Shpeshherë, ky model sjelljeje rezulton në një probabilitet më të lartë të keqpërdorimit të armëve të zjarrit nga individët në këtë grup demografik.

Një gamë hulumtimesh në rritje ka dokumentuar lidhjen mes normave specifike mashkullore dhe sjelljes së dhunshme.¹⁹ Gjatë viteve të fundit, studimet mbi ekspozimin e burrave ndaj dhunës me armë kanë theksuar lidhjet ndërmjet **perceptimit mbizotërues të burrërisë**, si dhe kërkesës për armë zjarri dhe keqpërdorimit të tyre. Perceptimi mbizotërues i burrërisë i referohet një grupi atributesh, sjelljesh dhe rolesh që zakonisht janë të lidhura me djemtë dhe burrat në një kontekst të caktuar social, kulturor dhe historik. Këto besime, të cilat përcillen nga prindërit, familjet, media, bashkëmohatarët dhe anëtarët e tjerë të shoqërisë, ushtrojnë trysni mbi burrat për t'u sjellë në përputhje me disa pritshmëri të caktuara.²⁰ Këto trysni u transmetojnë mesazhin se burrat duhet të jenë të pavarur, të sillen si të fortë, t'u qëndrojnë besnikë roleve strikte gjinore, të jenë të përgatitur që të përdorin dhunë për të zgjidhur konfliktet dhe të shmangin shfaqjen e shenjave të feminitetit. Këto sjellje dhe role të lidhura me maskilizmin apo burrërinë, zakonisht e vënë theksin te forca, në veçanti tek ajo fizike, guximi, gatishmëria për të marrë përsipër rreziqe, duke përfshirë përfshirjen në sjellje të rrezikshme, te pavarësia, vetësiguria, arritjet, ashpërsia, stoicizmi, suksesi, roli i personit që siguron jetesën, dhe te shmangia absolute e shfaqjes së dobësive. Studimet tregojnë se respektimi i këtyre mesazheve dhe trysnive mund të lidhet me ushtrimin dhe përjetimin e formave të ndryshme

18 Shihni: Shoqata Amerikane e Psikologjisë, Fjalori i Psikologjisë.

19 Brian Heilman me Gary Barker, 2018, *Masculine Norms and Violence, Making the Connections*, Promundo.

20 Po aty.

të dhunës, si dhe me sjellje të tjera të dëmshme. Gjithashtu, përfshin përdorimin e dominancës, dhunës, dhunës seksuale dhe kontrollit për të vendosur pushtet dhe superioritet.²¹ **Për më tepër, pushteti dhe kontrolli janë koncepte bazë për të përkufizuar perceptimin mbizotërues të burrërisë.**²²

Në këtë kontekst, armët e zjarrit mund të jenë veçanërisht tërheqëse për meshkujt e rinj në moshë pasi shpeshherë, ata i lidhin armët me burrërinë dhe në veçanti, me pushtetin dhe kontrollin.²³ Meshkujt e rinj në moshë shpesh i shohin armët e zjarrit si mjete për të fituar statusin social dhe ekonomik që ata besojnë se meritojnë. Atyre të cilëve u janë mohuar mundësitë normale drejt përparimit social dhe ekonomik, shfaqen veçanërisht të ndjeshëm ndaj tërheqjes simbolike të armëve të zjarrit. Tërheqja simbolike e armëve të zjarrit mund të jetë shumë e fortë, veçanërisht për meshkujt e rinj në moshë. Përtej shfaqjes së pushtetit dhe kontrollit, armët e zjarrit mund të jenë të lidhura gjithashtu me përmbushjen e pritshmërive mbi rolet gjinore dhe reputacionin në komunitet, ose për t'iu përgjigjur sfidave të perceptuara ndaj statusit dhe "burrërisë". Autorët e rinj në moshë shpesh e trajtojnë një armë si një mjet për të "mbrojtur statusin e tyre si persona të cilëve duhet t'ua kesh frikën dhe të cilët nuk duhen kundërshtuar". Dëshmitë anekdotike sugjerojnë se armët e zjarrit kanë qenë gjithashtu pjesë e riteve të kalimit të djemve të rinj në moshën e pjekurisë.

Studimet e mëparshme²⁴ në Evropën Juglindore tregojnë se janë disa faktorë që ndikojnë në shkallë të ndryshme në kërkesën e burrave për armë zjarri: perceptimi i tyre mbi sigurinë në komunitet; funksioni i perceptuar i armëve të zjarrit, pra nëse shërbejnë për mbrojtje personale, për qëllime gjuetie dhe sportive, pritshmëritë sociale nga meshkujt (si tradita, besimet që "një burrë duhet të mbajë armë zjarri", "nxit frikë tek të tjerët", ndjesitë e "pafuqisë sociale dhe ekonomike" dhe nevoja për të "rivendosur pushtetin përmes përdorimit të armëve", nevoja për t'iu pajtuar me nocionet mbizotëruese të burrërisë, ose të parit e armëve të zjarrit si një mjet për të fituar pushtet); përvoja me armët e zjarrit; dhe, ndër karakteristikat sociale-demografike në veçanti është moshë e të anketuarve.²⁵

Krahas natyrës gjinore që ka dhuna, duke përfshirë dhunën me armë, është po aq e rëndësishme që të mos nënvlerësohet roli i kontekstit më të gjerë social dhe tërësia komplekse e faktorëve të tjerë që përcaktojnë nëse meshkujt e rinj në moshë përdorin dhunë.²⁶ Ndër të tjerash, studiuesit theksojnë faktorë të tillë si kontrolli shtrëngues dhe i dhunshëm prindëror, mbikëqyrja e kufizuar prindërore, shoqërimi me bashkëmohatarë kriminelë, të qenit të dhunuar, të qenit dëshmitarë të dhunës ose ka përjetuar dhunë në shtëpi ose komunitet, aftësitë e kufizuara sociale; të pasurit e pikëpamjeve më tradicionale ose të ngurta në lidhje me gjininë, perceptimi i qëllimeve armiqësore tek të tjerët, ushtrimi i dhunës dhe perceptimi se

21 Shihni: Heilman, B., Barker, G., and Harrison, A. (2017), *The Man Box: A Study on Being a Young Man in the US, UK, and Mexico*, Washington, DC and London: Promundo-US and Unilever.

22 SEESAC, Gjinia dhe AVL-të në Evropën Juglindore: Problematikat kryesore dhe përgjigjet nëpërmjet politikave.

23 Shihni: Page, Ella, 2009, 'Men, Masculinity and Guns: Can We Break the Link?', IANSA; Mankowski, Eric. 2013. 'Antecedents to Gun Violence: Gender and Culture', In *Gun violence: Prediction, Prevention, and Policy*, American Psychological Association; Bevan, James and Nicholas Florian, 2006, 'Few options but the gun: Angry young men'. In *Small Arms Survey 2006: Unfinished Business*, Geneva: Small Arms Survey.

24 SEESAC, 2006, *The Rifle has the Devil Inside – Gun Culture in South Eastern Europe*.

25 Page, Ella, 2009, 'Men, Masculinity and Guns: Can We Break the Link?'

26 Bevan, James and Nicholas Florian, 2006, 'Few options but the gun: Angry young men'. In *Small Arms Survey 2006: Unfinished Business*, Geneva: Small Arms Survey.

ajo nxit respekt, çrregullimet e stresit post-traumatik. Për rrjedhojë, gjinia është një faktor i rëndësishëm parashikues, por hyn në lojë vetëm nëse janë të pranishëm një sërë faktorësh të tjerë socialë. Lidhjet midis disa prej pritsshmërive të burrërisë dhe armëve të zjarrit rrisin rrezikun që disa nëngrupe të meshkujve (kryesisht të rinjtë, por jo vetëm meshkujt e rinj), të përdorin armët, si dhe të jenë viktimë të dhunës me armë.

Për FFP-në, faktorët specifikë që i vendosin meshkujt (e rinj) në rrezik ose që nxisin sjelljet e rrezikshme duhet të merren gjithashtu në konsideratë gjatë zhvillimit të profilit të problemit dhe profilit të subjektit.

Mbështetur në këto rreziqe të vazhdueshme të identifikuar mes meshkujve të rinj, FFP-ja duhet të marrë në konsideratë zhvillimin e një profili të problemit të përfshirjes së meshkujve të rinj në moshë në kriminalitetin e lidhur me armët e zjarrit, për të ofruar një panoramë më të mirë rreth krimeve ekzistuese dhe të reja, ose serive të incidenteve, vendndodhjeve që kanë përparësi, dhe problematikave të tjera të identifikuar si me rrezik të lartë. Një profil i tillë specifik për problemin mund të ofrojë detaje për tendencat e krimeve të lidhura me meshkujt e rinj (duke përfshirë vendndodhjet më rrezikshme) që kërkojnë analizë më të detajuar se ajo që mund të ofrojë vlerësimi taktik, mund të ndihmojë për identifikimin dhe përzgjedhjen e subjektit (të dyshuarve ose viktimave), të mbështesë dhënien e përparësisë ndaj problemeve specifike që paraqesin rrezik, të ndihmojë me mangësitë në inteligjencë dhe të nxjerrë në pah mundësitë për parandalim, inteligjencë, zbatim dhe garanci.

Përveç profilit të problemit, aspektet gjinore të lidhura me meshkujt e rinj në moshë duhet gjithashtu të pasurojnë me informacion zhvillimin e profileve të subjektit për të ofruar një raport të detajuar për një të dyshuar ose viktimë, për të mbështetur hetimet gjatë këqyrjes së një krimi të rëndë ose serioz ose për të mbështetur hulumtimin. Profili i një subjekti duhet të mbështesë gjithashtu dhënien e përparësisë ndaj subjekteve për hetim.

Disa shqetësime dhe tregues specifikë të sjelljeve të rrezikshme lidhur me meshkujt e rinj në moshë që FFP-të duhet të marrin në konsideratë përfshijnë:

- aktet e dhunshme ndaj grave dhe anëtarëve të grupeve të caktuara të ndara, për shembull, sipas përkatësisë etnike, orientimit seksual, identitetit gjinor, aftësisë së kufizuar, moshës, fesë etj.
- veprat e mëparshme penale në moshë të mitur,
- lidhjet me bandat dhe huliganizmin,
- dhunën ndaj bashkëmoshatarëve, veçanërisht bullizmin,
- dhunën në aktivitete sportive,
- abuzimin me substancat, duke përfshirë alkoolin ose drogat, çka mund të jetë tregues i gjykimit të dobët dhe humbjes së vetëkontrollit,
- drejtimin e rrezikshëm ose të pakujdesshëm të automjetit,
- krimet kibernetike,
- mizorinë ndaj kafshëve, në veçanti shkaktimi i vuajtjes ose lëndimi i tyre.

Për sa i përket pranisë në media sociale dhe aktivitetit në internet, duhet t'i jepet vëmendje e veçantë çdo përmbajtjeje që:

- *nxit dhe lartëson dhunën në çdo kontekst,*
- *përmban qëndrime mizogjene, gjuhë urrejtjeje ndaj grave dhe vajzave, ose paragjykime të tjera të shprehura fuqishëm ndaj grave,*
- *justifikon dhunën ose bën thirrje për dhunë ndaj grave dhe vajzave ose dhunë me bazë gjinore, duke përfshirë dhunën, ngacmimin dhe abuzimin seksual,*
- *ka qëndrime pozitive ndaj të shtënave masive, duke përfshirë postime për autorët e të shtënave masive në të shkuarën,*
- *përmban gjuhë urrejtjeje apo qëndrime të dhunshme ndaj grupeve të caktuara të kategorizuara, për shembull, sipas përkatësisë etnike, orientimit seksual, identitetit gjinor, aftësisë së kufizuar, moshës ose fesë,*
- *tregon përfshirje në bullizëm kibernetik, ngacmim në internet ose krim kibernetik,*
- *tregon lidhje me banda,*
- *tregon radikalizëm ose ekstremizëm të dhunshëm,*
- *promovon dhunën në aktivitete sportive,*
- *promovon drejtimin e rrezikshëm ose të pakujdesshëm të automjetit,*
- *tregon mizori ndaj kafshëve.*

Këto lista kontrolli tashmë përdoren në Udhëzimet për miratimin me ndjeshmëri gjinore të lejeve për armë zjarri, të zhvilluara nga grupi rajonal i punës i përbërë nga përfaqësuesit e Ministrive të Brendshme nga Ballkani Perëndimor, me asistencën teknike të SEESAC.

Këto udhëzime synojnë të mbështesin profesionistët e përfshirë në miratimin e lejeve për armë zjarri që të integrojnë një perspektivë gjinore në procesin e miratimit, dhe në këtë mënyrë:

- të parandalojnë në mënyrë efektive keqpërdorimin e armëve të zjarrit në dhunën në familje, veçanërisht dhunën kundër grave, duke marrë parasysh rrethanat që mund të përbëjnë faktorë rreziku;
- të parandalojnë keqpërdorimin e armëve të zjarrit nga grupet që kanë më shumë gjasa për t'u përfshirë në sjellje të tilla, në veçanti meshkujt 18 deri në 30 vjeç.

Udhëzimet ofrojnë gjithashtu disa pyetje për intervistat që duhet të zhvillohen gjatë kontrollit të së shkuarës, të cilat synojnë të lehtësojnë vlerësimin e rrezikut. Këto pyetje synojnë të mbështesin më tej vlerësimin e sjelljeve të rrezikshme.

FJALORTH²⁷

Gjinia

Gjinia i referohet roleve, sjelljeve, aktiviteteve dhe attributeve që konsiderohen si të përshtatshme për gratë dhe burrat nga një shoqëri e caktuar dhe në një kohë të caktuar. Përveç attributeve shoqërore dhe mundësive që lidhen me të qenit mashkull ose femër dhe marrëdhënieve ndërmjet burrave dhe grave, dhe vajzave e djemve, gjinia gjithashtu i referohet marrëdhënieve ndërmjet grave dhe ndërmjet burrave. Këto attribute, mundësi dhe marrëdhënie janë ndërtuar në shoqëri dhe mësohen përmes shoqërizimit. Ato janë specifike sipas kontekstit dhe kohës dhe mund të ndryshojnë. Gjinia përcakton se çfarë pritet, lejohet dhe vlerësohet në një grua ose një burrë në një kontekst të caktuar. Në shumë shoqëri ekzistojnë diferenca dhe pabarazi ndërmjet grave dhe burrave në përgjegjësitë që u caktohen, aktivitetet që kryejnë, aksesin në burime dhe kontrollin mbi to, dhe në mundësitë për vendimmarrje. Gjinia është pjesë e kontekstit më të gjerë social dhe kulturor, ashtu siç janë kritere të tjera të rëndësishme për analizën social-kulturore duke përfshirë klasën, racën, nivelin e varfërisë, grupin etnik, orientimin seksual, moshën, dhe të tjera.

Normat gjinore

Normat gjinore janë ide rreth mënyrës se si gratë dhe burrat duhet të jenë dhe të sillen. Ato janë standarde dhe pritshmëri me të cilat gratë dhe burrat zakonisht pajtohen, sipas kornizave të përcaktuara nga një shoqëri, kulturë dhe komunitet i caktuar në një kohë të caktuar. Kur induktohen në moshë të hershme, normat gjinore mund të krijojnë një cikël shoqërizimi dhe stereotipizimi gjinor.

27 Përkufizimet e prezantuara në këtë fjalorth mbështeten në burime të ndryshme, duke përfshirë: 1. [Gender Equality Glossary \(Fjalorthi i barazisë gjinore\)](#), Qendra e Trajnimeve të UN Women; [Gender Training Manual for the Ministry of Defence of the Republic of Serbia and the Serbian Armed Forces \(Manual trajnimi për çështjet gjinore për Ministrinë e Mbrojtjes së Republikës së Serbisë dhe Forcat e Armatosura të Serbisë\)](#); UNDP SEESAC, [Gender Equality Glossary and Thesaurus \(Fjalorthi dhe glosari i barazisë gjinore\)](#); Instituti Evropian për Barazinë Gjinore.

Rolet gjinore	Rolet gjinore janë norma shoqërore dhe të sjelljes të cilat në një kulturë të caktuar konsiderohen gjerësisht të përshtatshme nga pikëpamja shoqërore për individët e një seksi specifik. Në tërësi, rolet gjinore shpesh përcaktojnë përgjegjësitë dhe detyrat tradicionale që u caktohen grave, burrave, vajzave dhe djemve (shihni ndarjen gjinore të punës). Rolet gjinore mund të evoluojnë me kalimin e kohës.
Seksi	Seksi (seksi biologjik) i referohet karakteristikave fizike dhe biologjike që i dallojnë meshkujt nga femrat. Këto karakteristika bazohen në faktorët fiziologjikë duke përfshirë: kromozomet seksuale, organet riprodhuese dhe rolet e ndryshme në riprodhim, hormonet dhe karakteristikat sekondare. Karakteristikat seksuale në përgjithësi mbeten konstante në të gjitha kulturat dhe me kalimin e kohës.
Barazia gjinore	Barazia gjinore i referohet të drejtave, përgjegjësiave dhe mundësiave të barabarta ndërmjet grave dhe burrave, dhe vajzave e djemve. Ajo nënkupton se interesat, nevojat dhe prioritetet e grave dhe burrave merren në konsideratë, duke njohur dhe pranuar diversitetin mes grupeve të ndryshme të grave dhe burrave. Barazia gjinore nuk është një çështje që prek vetëm gratë, por duhet të prekë dhe të përfshijë plotësisht burrat dhe gratë. Barazia ndërmjet grave dhe burrave shihet si një çështje e të drejtave të njeriut dhe si një parakusht për, ashtu edhe tregues i zhvillimit të qëndrueshëm me fokus njeriun.
Perspektiva gjinore	Një perspektivë që merr në konsideratë dallimet me bazë gjinore kur ekzaminojmë çdo proces, politikë dhe fenomen social. Termi “perspektivë gjinore” i referohet një qasjeje që analizon ndikimin e çështjeve gjinore te mundësitë e njerëzve, rolet sociale dhe ndërveprimet. Kjo qasje bën të mundur analizën gjinore dhe integrimin e mëpasshëm të një perspektive gjinore në çdo program, politikë ose organizatë të propozuar
Ndërgjegjësimi gjinor	Ndërgjegjësimi gjinor është një shqyrtim kritik i mënyrës se si dallimet në rolet gjinore, aktivitetet, nevojat, mundësitë dhe të drejtat/titujt prekin gratë, burrat, vajzat dhe djemtë në një fushë të caktuar politike, situatë apo kontekst. <i>Burimi: EIGE (Instituti Evropian për Barazinë Gjinore)</i>
Statistikat gjinore	Statistikat gjinore janë statistika që pasqyrojnë me saktësi dallimet dhe pabarazitë mes grave dhe burrave në të gjitha fushat e jetës. Statistikat gjinore përcaktohen nga karakteristikat vijuese: (a) të dhëna të ndara sipas seksit - të dhënat mbledhen dhe paraqiten të ndara sipas seksit si një klasifikim parësor dhe i përgjithshëm; (b) të dhënat pasqyrojnë çështjet gjinore; (c) të dhënat mbështeten në koncepte dhe përkufizime të cilat pasqyrojnë siç duhet diversitetin e grave dhe burrave, si dhe kapin të gjitha aspektet e jetëve të tyre; dhe (d) metodat e mbledhjes së të dhënave marrin në konsideratë stereotipet dhe faktorët socialë e kulturorë që mund të sjellin paragjykime gjinore. Shembuj të paragjykimeve mbi bazë seksi në mbledhjen e të dhënave përfshijnë nënraportimin e veprimtarisë ekonomike të grave, numërimin e shifrave më të ulëta për vajzat, lindjet dhe vdekjet e tyre, ose nënraportimin e dhunës kundër grave. <i>Burimi: EIGE (Instituti Evropian për Barazinë Gjinore)</i>

Të dhënat e ndara sipas seksit	Të dhënat e ndara sipas seksit janë të dhënat për individët e kategorizuar sipas seksit. Statistikat gjinore mbështeten në të dhënat e ndara sipas seksit dhe pasqyrojnë realitetet e jetëve të grave e burrave, si edhe çështjet politike lidhur me gjininë.
Integrimi gjinor	Integrimi gjinor i referohet vëmendjes sistematike ndaj dallimeve ndërmjet kushteve, situatave dhe nevojave të grave dhe burrave në të gjitha politikat dhe masat. Integrimi i perspektivës gjinore përfshin vlerësimin e ndikimit për gratë dhe burrat në çdo masë të planifikuar, duke përfshirë legjislacionin, politikat ose programet, në të gjitha fushat dhe nivelet. Është një strategji për t'i kthyer shqetësimet dhe përvojat e grave dhe të burrave në një pjesë integrale të përgatitjes, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të politikave dhe programeve në të gjitha sferat politike, ekonomike dhe shoqërore, në mënyrë që gratë dhe burrat të përfitojnë në mënyrë të barabartë dhe të mos ketë pabarazi. Synimi përfundimtar është të arrihet barazia gjinore.
Vrasja e grave (femicidi)	Vrasja e grave (e njohur gjithashtu si femicidi) është vrasja e qëllimshme dhe e motivuar nga gjinia e grave dhe e vajzave. I referohet vrasjes së një gruaje nga një burrë, të nxitur nga urrejtja ndaj grave, përbuzja, kënaqësia, ndjesia e pronësisë apo pushteti mbi gratë. Femicidi ndryshon në mënyra specifike nga vrasja e burrave. Për shembull, shumica e rasteve të vrasjeve të grave (femicidit) kryhen nga partnerët ose ish-partnerët, dhe përfshijnë abuzim të vazhdueshëm në shtëpi, kërcënime apo kanosje, dhunë seksuale, apo situata në të cilat gratë kanë më pak pushtet ose më pak burime se partnerët e tyre. ²⁸
Feminiliteti	Feminiliteti i referohet nocioneve të ndryshme se çfarë do të thotë të jesh grua, duke përfshirë modelet e sjelljes lidhur me vendin e supozuar të një gruaje në një tërësi të caktuar marrëdhëniesh dhe rolesh gjinore.
Burrëria	Burrëria i referohet nocioneve të ndryshme se çfarë do të thotë të jesh burrë, duke përfshirë modelet e sjelljes lidhur me vendin e një burri në një tërësi të caktuar marrëdhëniesh dhe rolesh gjinore.
Verbëria gjinore	Ky term i referohet paaftësisë për të kuptuar se rolet dhe përgjegjësitë e burrave dhe djemve dhe të grave dhe vajzave u caktohen atyre në kontekste dhe sfonde specifike sociale, kulturore, ekonomike dhe politike.
Ndjeshmëria gjinore	Ndjeshmëria gjinore i referohet karakteristikave të marrjes në konsideratë të normave, roleve dhe marrëdhënieve gjinore. Ajo tregon ndërgjegjësim gjinor, pavarësisht se shpesh nuk merret asnjë masë korrigjuese dhe nuk trajton pabarazinë e shkaktuar nga normat, rolet ose marrëdhëniet e pabarabarta.

28 World Health Organisation, 2012, [Understanding and addressing violence against women](#).

**Përgjegjshmëria
gjinore**

Përgjegjshmëria gjinore është qasja në të cilën gjinia është në qendër të arritjes së rezultateve pozitive. Kjo qasje e vendos gjininë në qendër të programimit, me synimin kryesor që të shndërrojë normat, rolet kufizuese gjinore dhe marrëdhëniet e pabarazisë së pushtetit. Ajo merr sistematikisht në shqyrtim normat, rolet dhe marrëdhëniet gjinore për gratë dhe për burrat, duke përfshirë nevojat e tyre të ndryshme dhe mënyrat se si këto dinamika formësojnë aksesin në burime dhe kontrollin mbi to. Programimi në këtë kategori zakonisht mbështet nismat për ta rishpërndarë pushtetin, për të përmirësuar vendimmarrjen e përbashkët dhe promovuar kontroll të barabartë të burimeve, ndërsa çon përpara fuqizimin e grave në mënyrë eksplicite. Ndërhyrjet synojnë qëllimisht dhe janë në dobi të grupeve specifike të grave ose burrave (ose të të dyve) për të përmbushur nevoja të veçanta ose për të arritur objektivat e përcaktuara në politika dhe programe.

Burimet e Përzgjedhura të SEESAC për Gjininë dhe Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta

[Keqpërdorimi i armëve të zjarrit në dhunën në familje në ballkanin perëndimor: tendencat kyçe dhe shqetësimet kryesore \(2025\)](#)

[Gratë në kontrollin e AVL-ve në ballkanin perëndimor \(2025\)](#)

[Studim mbi faktorët që nxisin kërkesën për armë zjarri dhe keqpërdorimin e tyre në ballkanin perëndimor – gjetjet dhe rekomandimet \(2025\)](#)

[Udhëzim: për zyrtarët e ministrive të punëve të brendshme dhe shërbimeve policore për komunikimin me mediat në rastet e keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën me bazë gjinore \(2024\)](#)

[Analizë e raportimit mediatic mbi keqpërdorimin e armëve të zjarrit në dhunën me bazë gjinore ndaj grave nga meshkujt në ballkanin perëndimor \(2024\)](#)

[Udhëzues për vlerësimin dhe adresimin e rreziqeve që lidhen me keqpërdorimin e armëve të zjarrit në dhunën në familje \(2024\)](#)

[Një instrument për miratimin me ndjeshmëri gjinore të lejeve për armë zjarri \(2024\)](#)

[In Focus Armed Violence Monitors](#)

[Guidelines for the Gender Analysis of Legislation and Policies Relevant for Small Arms Control \(2022\)](#)


[Anketim për Armët e Vogla dhe të Lehta \(2019\)](#)

[Men and Firearms in Southeast Europe, \(2019\)](#)

[Gender and Small Arms Fast Facts, \(2019\)](#)

[Çështjet gjinore dhe salw problematikat kryesore dhe përgjigjja me politika në evropën juglindore \(2016\)](#)

[Instrument praktik për integrimin e perspektivës gjinore në kuadrin ligjor dhe të politikave për armët e vogla dhe të lehta \(2016\)](#)



CIP

